Kumbona e së Diellës

Mantegna, Andrea - La Résurrection 1457-1459

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Nr.5/6, Mars - Prill 2018

PASHKA

KALIM NËPËRMJET VDEKJES NË AMËSHIM

Pashkët nuk janë asgjë tjetër përveç kalimi i mistershëm i Jezu Krishtit nga jeta tokësore nëpër mes vdekjes në jetën e pasosur. Kjo festë krishtere rrjedh nga festa hebraike "pasha" ("peseh"), përkujtimi i madhështor i kalimit etërve të tyre nga skllavëria e Egjiptit, nëpër Detin e kuq, në liri kah toka e premtuar. Ndodhia e Besëlidhjes së vjetër është përfytyrimi i çlirimit i njeriut nga skllavëria e mëkatit, vdekjes, varrit, shkatërrimit të përjetshëm. Nuk mbet fjala e fundit e varrit as rrasës së varrit por jetës nëpërmes Jezu Krishtit.

Pas vdekjes dhe errësirë shpërthen rrezja e ngjalljes. Nga ndodhitë e natës së errët. Nga hiçi. Në mëngjesin e hershëm të dielës ditës së parë nxënësit ballafaqohen me Jezusin e ngjallur. Ngadalë u kthjelluar nga retë e zymta dhe të dyshimit. Besimi ringjallet në zemrat e besimtarit.

Dhe në fund ju përkujtoj vetes dhe të gjithëve që kremtojnë Pashkët se të gjithë ne jemi në rrugën për në Emaus "Ecclesia peregrinans". Gjatë kësaj rrugë Jezusi na bashkëngjitet por shpesh nuk e njohim!

Bashkësia e hershme krishtere e njoh në thyerjen e bukës që i themi Eukaristia (Mesha)!

Nga zemra ju dëshiroj që të mos ta humbim besimin dhe vetëbesimin në tragjeditë e të Premtes së Madhe. Por në rrugën e Emausit ta rinjohim Jezu Krishtin në vëllai, motrën, në afërmin, fqinjë dhe në çdo njeri vëlla e motër.

Don Nosh Gjolaj

Papa Françesku
MESAZHI URBI ET ORBI 4

Don Lush GJERGJI
SHENJTËRESHË PËR DASHURI 6

Dom Gjovani K. Kokona
MIDIS TRADITËS DHE UNGJILLIT 9

Papa Françesku
HIRI I PENDIMIT 11

Papa Françesku
JEZU KRISHTI SOT KA EMRIN E ROHINGIAVE 13

Dom Nosh Gjolaj
GATISHMËRIA PËR T'U MËSUAR 14

Luljeta Dushi
MËNYRA E BESIMTARIT PËR T'JU DREJTUAR ZOTIT 17

Ndue Dedaj
LETRA E PAPËS PALI VI NË 500-VJETORIN E SKËNDERBEUT 20

Prof. Georg Stadtmüller
ISLAMIZIMI I SHQIPTARËVE 22

MOMENTE ME KULTURËN SHPIRTERORE 27

VITRINA E LIBRIT 28

KUMBONA E SË DIELLËS
Viti XXXI, nr. 3/4 (505-506) Mars - Prill 2018

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon NIKA
Fotografe: Luli Ndreu

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

Papa Françesku

MESAZHI URBI ET ORBI: NGJALLJA E KRISHTIT, SHPRESË E VËRTETË, QË NUK ZHGËNJEN

Në një Shesh të mbushur përplot me besimtarë, pavarësisht nga alarmizmat, Papa Françesku, nga lozha e Bazilikës së Shën Pjetrit u lut për paqe në të gjitha vendet e botës, ku ka padrejtësi e dhunë, duke theksuar: "Ngjallja e Krishtit, është shpresë e vërtetë, që nuk zhgënjen!". Por ta ndjekim vetë mesazhin e Papës drejtuar Romës e Botës:

Të dashur vëllezër e motra
Jezusi u ngjall prej të vdekurve!

Jehon përsëri në mbarë botën ky kumt, njëherësh me këngën Aleluja: Jezusi është Zoti, Ati e ngjalli e Ai është i gjallë përgjithmonë mes nesh.

Jezusi vetë e pati paralajmëruar vdekjen e ngjalljen me figurën e kokrrës së grurit. Thoshte: "Nëse kokrra e grurit e mbjellë në dhe nuk vdes, mbetet e vetme; po nëse vdes jep shumë fryt! (Gjn 12,24), Ja, pikërisht kjo ndodhi: Jezusi, kokrra e grurit, e mbjellë nga Zotit në brazdat e tokës, vdiq i vrarë nga mëkati i botës, mbeti dy ditë në varr; por brenda vdekjes së Tij ishte i gjithë pushteti i dashurisë së Zotit, që shpërtheu vrullshëm e u duk në të tretën ditë, në këtë, që po e kremtojmë sot: në Pashkët e Zotit.

Ne, të krishterët, besojmë e shpresojmë se Ngjallja e Krishtit është shpresa e vërtetë e botës, ajo, që nuk të zhgënjen. Është forca e kokrrës së grurit, e dashurisë që përulet e dhurohet deri në fund të fundit e që e rinon vërtet botën. Kjo forcë sjell fryt edhe sot në hullitë e historisë sonë, përplot me padrejtësi e dhunë. Sjell frytet e shpresës e të dinjitetit atje, ku ka mjerim e përjashtim, ku ka uri e papunësi, ku ka të ikur e refugjatë - tepër shpesh të papranuar nga kultura e sotme e hedhurinës – ku ka viktima të trafikut të drogës, tregtisë së njerëzve e skllavërive të kohëve tona.

E ne sot i lypim Zotit fryte paqeje për botën mbarë, duke nisur nga Siria e dashur dhe e martirizuar, popullsia e së cilës u dërrmua nga një luftë, që nuk po di të mbarojë. Në këto Pashkë, drita e Krishtit të Ngjallur i shndritët ndërgjegjet e të gjithë drejtuesve politikë dhe ushtarakë, që t'i jepet fund menjëherë shfarosjes në vijim, të respektohet e drejta humanitare dhe të parashikohet shpejtimi i hyrjes së ndihmave, për të cilat kanë aq shumë nevojë këta vëllezër e motra, duke siguruar, njëkohësisht, edhe kushtet e përshtatshme për rikthimin e gjithë të shpërngulurve.

Fryte pajtimi i lypim Zotit për Tokën Shenjte, edhe këto ditë e plagosur nga konfliktet e hapura, që nuk i kursejnë as njerëzit e pambrojtur; për Jemenin e për mbarë Lindjen e Mesme, që dialogu dhe respekti reciprok të kenë epërsi mbi përçarjet e dhunën. Vëllezërit tanë në Krishtin, që shpesh pësojnë padrejtësi e persekutime, qofshin dëshmitarë të ndritshëm të Krishtit të Ngjallur dhe të fitores të së të mirës mbi të keqen.

Fryte shprese i lypim Zotit këto ditë, për të gjithë ata, që kanë etje për jetë dinjitoze, posaçërisht në ato anë të kontinentit afrikan, që vuajnë nga uria, konfliktet endemike e terrorizmi. Paqja e Zotit i shëroftë plagët e Sudanit të Jugut; i haptë zemrat për dialog e mirëkuptim reciprok. Pa harruar viktimat e këtij konflikti, posaçërisht fëmijët! Mos u mungoftë solidariteti shumë njerëzve, të detyruar t'i braktisin trojet e tyre e të mbeten pa gjërat më të nevojshme për jetën.

Fryte dialogu kërkojmë për gadishullin korean, duke uruar që bisedimet në vijim të nxisin harmoninë e paqëtimin e rajonit. Urojmë që ata, të cilët kanë përgjegjësi të drejtpërdrejt, të veprojnë me urti e arsye, për të siguruar të mirën e popullit korean e për të krijuar marrëdhënie mirëbesimi në gjirin e bashkësisë ndërkombëtare.

Fryte paqeje kërkojmë për Ukrainën, që të fuqizohen hapat në favor të harmonisë e të lehtësohen nismat humanitare, për të cilat ka aq shumë nevojë popullsia.

Fryte ngushëllimi kërkojmë për popullin venezuelan i cili - siç shkruajnë Barinjtë e tij - jeton si të ishte në dhe të huaj, në trojet e veta. Gjetët, përmes forcës së Ngjalljes së Zotit Jezus, udhën e drejtë, paqësore e njerëzore për të dalë sa më shpejt nga kriza politike dhe humanitare, që e mundon, e mos i mungofshin mikpritja e asistenca bijve, që detyrohen të largohen nga atdheu i tyre.

sjelltë Krishti i Ngjallur për fëmijët të cilët, për shkak të luftërave dhe të urisë, rriten pa shpresa, pa edukim, pa ndihmë shëndetësore, e edhe për pleqtë e flakur nga kultura egoiste, që e lë mënjanë kë nuk "prodhon".

Fryte urtie kërkojmë për ata, të cilët, në mbarë botën, kanë përgjegjësi politike, që të respektojnë gjithnjë dinjitetin njerëzor, të përpiqen me përkushtim në shërbim të së mirës së përbashkët e të sigurojnë zhvillimin dhe sigurinë e qytetarëve të vet.

Të dashur vëllezër e motra,

Edhe ne, si gratë, që vrapuan tek varri, na drejtohet kjo fjalë: "Pse e kërkoni ndërmjet të vdekurve atë, që është i gjallë?" Nuk është këtu, u ngjall! (Lk 24,5-6). Vdekja, vetmia e frika nuk janë më fjala e fundit. Është një fjalë, që shkon përtej e që mund ta shqiptojë vetëm Zoti: fjala e Ringjalljes (krh Gjon Pali II, Fjalët në përfundim të Udhës së Kryqit, 18 prill 2003). Me forcën e dashurisë së Zotit, ajo e mund të keqen, i lan mëkatet, ua rikthen pafajninë mëkatarëve, gëzimin të munduarve, davarit urrejtjen, përkul forcën e të pushtetshëmve, nxit harmoninë e paqen!

Gëzuar Pashkët, të gjithëve!

Don Lush GJERGJI
Prishtinë

SHENJTËRESHË PËR DASHURI – NËNA TEREZË (1910-1997)

Kemi 38 vjetorin e Çmimit Nobel për Paqë ; 20 vjetorin e vdekjes; 1 vjetorin e shenjtërimit; viti i shugurimit të Shenjtërores "Nëna Tereze" në Prishtinë.

Vitin që po e lëmë pas, 2017, për ne, Kishën katolike dhe popullin Shqiptar kudo në botë, ka qenë i shënuar dhe i bekuar, i frytshëm dhe domethënës në shumë kuptime dhe drejtime, sidomos në përkujtimin e përvjetorëve të Shën Nënës Terezë:

38 - vjetori i Shpërblimit Nobel për Paqe, në Oslo (Norvegji), 10 dhjetor 1979;

20 - vjetori i vdekjes së Shën Nënës Terezë, në Kalkutë, 5 shtator 1997;

1- vjetori i shenjtërimit të Nënës Terezë nga Papa Françesku, në Vatikan (Romë), 4 shtator 2016; Shugurimi i Shenjtërores dhe Katedrales "Nëna Terezë" në Prishtinë, 5 shtator 2017.

Këto ngjarje shënojnë historinë e Kishës Katolike në popullin Shqiptar, si dhe historinë tonë kombëtare, me domethënie dhe porosi të mëdha dhe shumë aktuale për ne, por edhe për mbarë njerëzimin.

Ta njohim, zbërthejmë, shqyrtojmë, përjetojmë Nënën tonë Terezë, tiparet e saja dalluese, porositë e saja karakteristike, risitë që i ka dhuruar Zoti nëpërmjet saj, domethënien për ne dhe prej brezat e ardhshëm, veçoritë që atë e kanë karakterizuar dhe dalluar, sidomos në domethënien e fesë dhe të dashurisë së krishterë.

Tashmë ka kaluar koha e njohjes, paraqitjes, nderimit, admirimit, lartësimit të Shën Nënës Terezë. Jemi në një fazë të re dhe shumë të nevojshme, të rëndësishme, do të thosha për ne edhe vendimtare: urata, kulti i saj ndër ne, që përgatit dhe mundëson edhe imitimin e jetës dhe veprave të saja. Me shenjtërimin e Nënës Terezë, si dhe me ndërtimin dhe shugurimin e Shenjtërores kushtuar asaj në Prishtinë, mundësitë e njohjes dhe rritjes së përshpirtërisë ndaj Shenjtëresës sonë, janë të mëdha dhe me perspektiva tejet të rëndësishme për Kishën tonë.

Nënën Terezë Bojaxhiu e kam takuar shumë herë gjatë njohjes, shoqërimit dhe bashkëpunimit me të, në meridianët të ndryshme të botës, që nga takimi im i parë personal në vjeshtë në Romë në vitit 1968. Unë atëherë isha student i vitit të dytë të filozofisë në Universitetin "Urabanian" në Romë. Atë e kam shoqëruar në pesë vizitat e saja në Kosovë: 1970, 1978, 1980, 1982 dhe 1986;

isha me të gjatë Çmimit Nobel për Paqe (Oslo, 1979); në shumë vende të Evropës Lindore; sidomos në Kalkutë dhe në rrethinë (1989)...

Çdo takim ishte si i pari dhe i fundit, që më bënte përshtypje thjeshtësia, çiltëria, mirësia, bujaria, duresa, kujdesi dhe dashuria për të varfër ndër më të varfër, të gërbulur, ata që askush nuk i donte, sidomos malli për Atdhe, lidhja e ngushtë shpirtërore me Popullin dhe Kishën ndër Shqiptarë, por edhe vuajtja me ne dhe për ne, por edhe për njerëzit e mbarë botës.

Gjithnjë kam studiuar dhe hulumtuar për rrënjët, burimin, zanafillën e këtij përkushtime dhe dashurie kaq prekëse dhe tërheqëse për mbarë botën. Përfundimi im është ky: janë dy burime unike që e kanë përgatitur dhe dhuruar atë gjithë botës: tradita dhe përvoja familjare, kombëtare shqiptare, që mbështetet në këto parime të shenjta dhe domethënëse: "Bukë, krip dhe zemër", dhe: "Shtëpia është e Zotit dhe mysafirit", si dhe përvoja dhe jeta dashurisë së krishterë në familje dhe në bashkësi famullitare, porosia e Jezusit që identifikohet me çdo njeri: "Çka do bëtë për njërin ndër këta vëllezër të mi më të vegjël, e bëtë për mua" (Mt 25, 40). Ajo ishte Dashuria në veprim, siç e kam definuar unë. Me 17 libra kushtuar Nënës Terezë, të përkthyera në shumë gjuhë botërore, jam munduar t'i dokumentoj dhe argumentoj këto dy burime të pashtershme për Nënën Terezë: Zotin - Dashuri dhe vëllain apo motrën Njeri.

1. Disa risi në jetën dhe veprën e Nënës Terezë: feja, shpresa dhe dashuria

Ndër risitë më të rëndësishme që kam hetuar unë janë këto: feja - që për Nënën Terezë ishte kërkim i Zotit në Njeriun dhe i Njeriut në Zotin në çdo fazë të jetës së saj. E kishte kërkuar Zotin dhe thirrjen, planin e tij prej moshës 12 deri 18 vjeçare, kur kishte vendosur plotësisht t'i kushtohet atij: "Dua të bëhem motër misionare për t'i ndihmuar të varfrit e botës" (Letnicë, 14 gusht 1928). Gjatë 18 viteve si "Motër e Loretos" dhe së fundi prej vitit 1950 e deri te kalimi në amshim. Ajo kurrë nuk e ka ndarë Zotin prej Njeriut dhe Njeriun prej Zotit.

Shpresa – veprim gjithnjë dhe kudo me dashuri dhe për dashuri, me parimin: "Kudo që jeta është në rrezik, aty duhet të jemi ne".

Dashuria – flijim dhe dhurim pa kursim për t'u bërë dhe mbetur Nëna e Dashurisë.

2. Nëna universale – universalizmi i jetës dhe dashurisë

Misioni i Nënës Terezë është Dashuria, vendveprimi është bota, mbarë njerëzimi, metodologjia është dëshmia e krishterë, qëllimi është lehtësimi dhe pakësimi i vuajtjeve, mënyra është pjesëmarrja e plotë dhe e lirë në jetën e tyre, të privilegjuar janë të braktisurit dhe të dëbuarit e botës.

Risia e dytë e Nënës Terezë ishte UNIVERSALIZMI në çdo kuptim dhe drejtim kohor dhe hapësinor në dy parime themelore: Për Zotin – Dashuri dhe Njeriun – vëlla apo motër, pra, i jetës dhe dashurisë.

Askush në historinë e njerëzimit, as në atë të krishterimit, nuk kishte nisur në vepër të tillë pa kurrfarë përjashtimi kombëtar, fetar, gjinor, kastor, shoqëror, dhe vetëm ajo kishte arritur që t'i bashkonte të gjithë, hinduistët, budistët, myslimanët, të krishterët, ateistët, gnostikët, me fuqinë e fesë dhe frymëzimin e dashurisë. Ajo nuk kishte për qëllim kthimin e të tjerëve në fenë e krishterë, në Kishën Katolike, por "që të jetë në mesin e tyre rrezja e Pranisë dhe e Dashurisë së Zotit, që t' ua dhurojnë të gjithëve Zotin – Dashuri – Atë".

Qëllimi i saj, pra, ishte diçka tjetër, dashuria dhe prania e Zotit në botën e sotme, sidomos ndër të varfrit më të varfër, të braktisur, të gërbulur, njerëz të përbuzur dhe të përjashtuar nga jeta e rëndomtë, për t'ua dëshmuar të gjithëve se çdo njeri është së pari Njeri, i afërmi ynë, vëlla apo motër, deri te ajo që në çdo Njeri ta shohim, njohim, duam dhe shërbejmë vetë Jezusi, dhe këtë me shembullin e jetës dhe dëshminë e përditshme.

Ja çka thotë Nëna Terezë për motrat që i ka themeluar ajo me emërtim "MISIONARET E DASHURISË": "Misionarja e Dashurisë duhet dhuruar, por mbi të gjitha duhet ta dhurojë vetveten… Për t'iu dhuruar të varfërve dashuri, ne duhet të jemi të afta ta duam njëra-tjetrën në bashkësinë tonë rregulltare, t'i dhurohemi tërësisht Zotit nëpërmjet të afërmit, nevojtarit… Ne jemi motra rregulltare dhe thirrja jonë nuk është puna me të gërbulur, apo me njerëz në buzë të vdekjes: Thirrja jonë është të jemi tërësisht të Jezusit. Pasi jam e Jezusit, puna ime është mjet për ta treguar dashurinë ndaj Tij. Prandaj puna është mjet e jo qëllim jete".

qenë rrezja e Dashurisë së Zotit. Ata që vuajnë duhet të gjejnë në ne Ungjillin ngushëllues... Çdoherë kur e takoni Jezu Krishtin në të varfër, buzëqeshini. Nëse nuk doni t'i buzëqesheni Jezusit në të varfër, më mirë mos dilni fare ose kthehuni së shpejti në kuvend...".

Ja, prapë mrekullia e dashurisë dhe e shenjtërisë: Më e varfra e botës, Nëna Tereze, më së shumti i ka ndihmuar të varfrit e botës, jo vetëm në anën materiale, por edhe më tepër në atë shpirtërore dhe morale, sepse është dhuruar falas dhe tërësisht, me gëzim dhe me dashuri të plotë Zotit nëpërmes njeriut.

3. Vuajtja – bekim e jo mallkim

Risia e tretë e Nënës Terezë është kjo: vuajtja, pësimi, mjerimi, varfëria, gërbula, Sida, si dhe çdo pësim tjetër, nuk është mallkim, dënim i Zotit, por hir, mundësi për ta treguar dashurinë ndaj Jezusit që vuan në njerëz të tillë. Ajo e shihte, e njihte, e shërbente dhe e dashuronte Jezu Krishtin në ata që nuk kishin më as pamje njerëzore.

Ajo thoshte kështu:"Të varfrit na japin ne shumë më tepër, na dhurojnë mundësinë që konkretisht ta duam dhe ta shërbejmë Jezusin i cili pëson në ta. Ata na japin falënderimin… Paqja do të vijë në botë nëpërmjet të varfërve. Të varfrit janë të detyruar të jenë të tillë, ndërsa ne jemi të varfra për dashuri ndaj Jezu Krishtit dhe për t'i kuptuar deri në fund ata që nuk kanë asgjë duke jetuar si ata dhe me ata... Ne varemi tërësisht prej Provanisë hyjnore… Ja ana më e bukur e rregullit tonë… Jepni duart tuaja për shërbim të varfërve, zemrën tuaj për t'i dashur të varfrit. Dashuria e vërtetë është gjithmonë flijim dhe dhurim".

4. Dhurim falas dhe në tërësi

Risia e katërt e Nënës Terezë është dhurimi falas dhe në tërësi, me dashuri dhe për dashuri, me hare dhe falënderim. Ajo shpeshherë thoshte kështu: "Nëse nuk mund të bësh asgjë për të tjerët, atëherë së paku buzëqeshu, sepse kjo nuk të kushton asgjë, por jep shumë. Gëzimi duhet të jetë një ndër thesaret e jetës sonë… Kështu më thoshte Nëna Loke: "Gonxhe Gjyli, bija ime, ose bëre këtë punë me zemër, ose mos e bën aspak!".

Dhe vazhdon kështu: "Unë ju kam thënë motrave përgjegjëse për bashkësitë tona: Bota është plot mjerime, vuajtje, pikëllime. Ne duhet të dalim në botë për ta pakësuar vuajtjen, për të

5. Kontemplative aktive në botë

Veçoria e pestë e Misionareve të Dashurisë është kjo: kontemplative aktive në botë. Kjo do të thotë të jenë tërësisht të kushtuara Zotit në lutje, meditim, adhurim, pendesë, dhe si pasojë e kësaj jete shpirtërore, të jenë edhe aktive në botë me dashuri vepruese. Pse dhe si? "Të gjitha për Jezusin, në Jezusin dhe me Jezusin".

Urata, meditimi, adhurimi, mesha, kungimi, me një fjalë e tërë jeta shpirtërore ka për qëllim që motrat të aftësohen për dashuri, për dëshmi, për veprim, për ta njohur, ndihmuar, dashur dhe shërbyer Jezusin në njerëz që vuajnë.

Kontemplative aktive domethënë ta kërkojmë, gjejmë, shërbejmë Zotin jo vetëm në çaste të kushtuara atij, në jetën tonë shpirtërore, por gjithkund dhe gjithnjë pikërisht me fuqinë e fesë dhe me frymëzimin e dashurisë.

Nëna Tereze thoshte: "Nëse e njohim, duam, adhurojmë, ushqehemi me Jezu Krishtin vetëm në meshë, në Kungim, është tepër pak. Ne lutemi, meditojmë, adhurojmë, marrim pjesë në meshë, e marrim Jezusin në Kungim në zemër për ta vazhduar këtë kërkim dhe shoqërim me të në përditëshmëri. Nëse e gjejmë dhe shërbejmë Jezusin në të varfrit tanë, atëherë jemi kontemplative në mesin e botës".

Për këtë Nëna jonë Tereze ishte dhe gjatë do të mbesë Ungjilli i gjallë, risia ungjillore, Misionarja e Dashurisë, Nëna e botës së mjerimit, tash Shenjtëresha e Jetës dhe Dashurisë.

Dom Gjovani K. Kokona
Kanada

MIDIS TRADITËS DHE UNGJILLIT

Në emisionin televiziv Arkapia e ftuara Ledi Shkreli duke folur mbi Atë Zef Pllumin dhe françeskanë të tjerë u shpreh me një keqardhje se: "ajo ishte një plejadë që nuk vjen më". Por në një farë mënyre ky lloj pesimizmi, kur kujtojmë figura të ndritura të Kishës katolike në Shqipëri, na kap edhe ne. E megjithatë nëse reflektojmë pak nuk duhet të na kapë pesimizmi. Sepse nëse ndoshta mund të jetë e vërtetë që ajo lloj plejade "nuk vjen më" po aq është edhe e vërtetë që "vjen një plejadë tjetër". Çdo kohë ka lajmëtarët e vet. Tentativa, e gabuar, për të kopjuar apo për të imituar atë periudhë të Fishtës, Justin Rrotës, Bernardin Palajt e të tjerë; nuk jep rezultat. Të ndalesh te tradita pa e kontestualizuar është si të duash të mbetesh në një muze. Por vjen momenti kur nga muzeu duhet të dalësh sepse jeta të thërret me të mirat e të këqijat e veta. Prandaj do thoja se më shumë se kopjimi i asaj plejade do të duhej një lloj marrje shembull sesi ata identifikuan problemet/nevojat e kohës dhe u angazhuan gjithsecili në fushën e vet për t'iu përgjigjur atyre nevojave.

E cilat janë nevojat sot? – është pyetja jonë. Pa identifikuar nevojat nuk mund të ofrojmë rrugëzgjidhje. A janë edhe sot madhore problemet e kufijve të Shqipërisë, apo çështja gjuhësore; apo ka të tjera? Personalisht mendoj se sot më shumë përballemi me sfidën si të dhurojmë risinë e Ungjillit, si ta bëjmë tërheqëse në një ambient me sfida moderne dhe të kaluara. Moderne sepse teknologjia ka ndikimin e vet por edhe të kaluara në një shoqëri si tonën ku ndikimi qoftë në mentalitet dhe qoftë në praktikë (në disa forma) i kulturës komuniste vazhdon të ndikojë. Ky mentalitet komunist gjeti mbështetje edhe te jo pak misionarë/e të vitet '90 të cilët ishin rritur nën frymën e majtë të viteve '60/'70. Kjo frymë në zonat shqiptare me traditë katolike (sidomos zona e Zadrimës, zona e Nen-Shkodrës, por edhe zona te tjera) u përplas me dëshirën/nevojën e besimtarëve për t'ju rikthyer traditës që për vite iu ishte mohuar. Natyrisht është një fenomen që nuk ndodh vetëm te ne, por tek ne në fillim mund të ishte më e fortë sepse edhe "dalja" nga sistemi zyrtar ateist ishte i menjëhershëm. Mjafton të kujtojmë turmat në Meshat e para te varrezat e Rrmajt. Shumë prej tyre më pas vazhduan të mbeten në një nostalgji tradite por e pa thelluar në Ungjill. Ndoshta do ishte dashur të mos sulmohej tradita, duke iu hequr kështu bazën këtyre besimtarëve, për të futur diçka të re të panjohur (shpesh duke abuzuar në emër të një koncili). Sigurisht më e përshtatshme, mendoj, do të kishte qenë përpunimi i traditës në frymën e Ungjillit. Të mos harrojmë që edhe ajo traditë aty në Ungjill e në Kryq e kishte, e ka, burimin.

Këto ditë kur një 'komision liturgjik' po tenton

të hartojë një tekst këngësh liturgjike në nivel kombëtar është për të pyetur sesa komisioni, anëtarë të tij, e kanë pasur, e kanë, kujdesin për të parë, në radhë të parë se cila është tradita e këngëve liturgjike apo e lutjeve të ndryshme në zonat e Shqipërisë. Ky hulumtim, jo vetëm në këtë aspekt, është i nevojshëm që ne të mos vazhdojmë të kopjojmë thjesht gjëra të të tjerëve por që nuk prekin zemrat e njerëzve. Ndodh jo rrallë herë që dëgjon këngë liturgjike të traditës shqiptare në New York, por jo në Shqipëri. Ose nganjëherë mundohen të imponohen shenjtër apo themelues të një kongregatë sikur zonat apo famullitë të mos kenë një pajtor të tyre që nga kohëra që nuk kujtohen.

Fjala këtu është që çdo vend aktualizon dhe propozon Ungjillin, risinë e tij, në kontekstin vendas. Por që ta bësh këtë duhet në radhë të parë ta njohësh atë kontekst. E kujtoj një herë kur i thashë një "misionari": ti mundohesh të dijë se ç 'ndodh në Shqipëri duke dëgjuar lajmet te RAI. Konteksti ka gjithmonë rëndësi në mënyrë që të jesh efektiv në atë që propozon. Për shembull nuk mund të trajtosh në të njëjtën mënyrë Malësinë e Madhe me Nënshkodrën apo me Mirditën, por edhe këto kanë një tjetër ecje në krahasim me Malësinë e Tuzit apo me Rrafshin e Dukagjinit apo të Fushë-Kosovës. Kujtoj sesi para dy vitesh një meshtar do merrte një famulli dhe pa hyrë akoma, duke biseduar, më paraqiti gjithë një program që donte të fillonte aty; por duke ia shprehur mendimin tim i them: prit një herë të fusësh këmbët se duhet të kuptosh tokën ku po shkel.

Por duke iu rikthyer asaj shprehje "që ajo plejadë e kaluar françeskane apo klerikësh nuk vjen më", mund të them se vjen, bilës është e pranishme por ne vetë duhet të jemi të vetëdijshëm për të e duhet ta zbulojmë/ri zbulojmë atë. Sa here kemi dëgjuar në Shqipëri, edhe në muajt e këtij viti, që kur flitej për klerin vendas dhe përgjegjësitë që duhej të merrte, pritej shkurt me fjalët: janë të rinj, duhet të piqen akoma; e Papa Françesku me një mjeshtëri të mprehtë e hodhi poshtë këtë duke treguar që gjykimi shkon te personi dhe jo personi të gjykohet në bazë ideologjike apo përkatësie grupimi ose prejardhje.

Pra kemi shumë për të bërë që të zbulojmë vetveten që as të mos mbetemi një Kishë ku vetëm idealizohet një e kaluar e lavdishme, dhe as të mos mbetemi në tundimin që gjithçka po krijohet me ne (e do të vdesë me ne). Krishti i djeshëm është edhe ai i sotëm e do të mbetet edhe ai i të nesërmes, Atij i takon lavdi dhe ndera. Prandaj edhe kësaj plejade të sotme, sikur asaj të djeshme, i mbetet përgjegjësia sesi të vazhdojmë ta aktualizojmë e propozojmë Fjalën e Mishëruar, Dritën e vërtetë, që "për ata që e pranuan u dha zotësinë të bëhen bijtë e Hyjit".

PAPA FRANÇESKU: HIRI I PENDIMIT

(Lutja e mëngjesit në kishën «*DOMUS SANCTAE MARTHAE*»)

përballë Zotit të gjithëfuqishëm, që ai të na përqafojë me të gjithë mëshirën e tij. Dhe për të kërkuar falje na tregon rrugën e drejtë profeti Baruc" - ka theksuar Papa Françesco në meshën që ka celebruar më 6 tetor, në Santa Marta.

Në fakt, " leximi i parë është një akt i pendesës" – Papa e ka nënvizuar menjëherë duke iu referuar fragmentit të librit të Baruc (1, 15-22). Populli pendohet përpara Zotit dhe kërkon falje për mëkatet e tij : pendohet duke shikuar lavdinë e Zotit dhe duke kujtuar gjërat e shëmtuara që ai ka bërë. Është fragmenti i profetit Baruc që fillon kështu : " Zotit tonë, drejtësi". Ai është i drejtë dhe ne kemi pandershmërinë e vizatuar në fytyrë.

Prandaj, ka nënvizuar Papa "ndihen kështu, nuk kanë nder dhe me këtë zemër kërkojnë falje". Nuk thonë " kemi bërë këtë, këtë, këtë…". Gjërat që kanë bërë gjithmonë, i thonë në raport me Zotin dhe përballë Zotit. Është kjo mënyra sesi duhet të pendohemi : i gjithë populli pendohet, në atë moment, dhe kërkon falje për të gjithë banuesit e Jeruzalemit, për mbretërit tanë dhe për kapitenët tanë; për profetët tanë dhe priftërinjtë tonë, pasi kemi mëkatuar kundër Zotit.

Kjo do të thotë që të gjithë jemi mëkatar – ka ritheksuar Papa Francesco. Asnjëri nuk duhet të thotë që " unë jam i drejtë", apo "unë nuk jam si ai, apo ajo". Ne duhet të pranojmë që jemi mëkatarë. Dhe "unë do të thosha që emri i parë që ne kemi është "mëkatar" - ka thënë Papa, duke na pyetur ne se përse jemi mëkatarë. Nuk i jemi bindur Zotit : ai na ka thënë një gjë dhe ne kemi bërë një gjë tjetër. Ne nuk e kemi dëgjuar zërin e Zotit, ai na ka folur shumë herë. Në fakt, ka insistuar : "në jetën tonë secili nga ne mund të mendojë : sa herë Zoti më ka folur, sa herë nuk e kam dëgjuar" ? Për shembull, ka vazhduar, " ka folur me prindërit, me familjen, me katekistin, në kishë, në predikime, ka folur edhe në zemrat tona : le të dëgjojmë zërin e Zotit; por ne nuk kemi dëgjuar atë zë që na thoshte "Ec sipas udhëzimeve që ai na kishte dhënë".

Lexohet akoma në fragmentin e Baruc që i propozohet liturgjisë : " Ne i jemi rebeluar Zotit, Zotit tonë" dhe mëkati është gjithnjë i njëjtë, pasi mëkati i izoluar nuk ekziston. Mëkati gjithnjë është mëkat pasi është në raport me Zotin. Madje ka shpjeguar Papa se mëkati i izoluar është gjithnjë një gjë e shëmtuar përballë Zotit, në raport me të. Dhe kështu ka vazhduar Papa duke i cituar fjalët e pjesës së Baruc " i jemi rebeluar atij, jemi treguar

kokëfortë duke mos e dëgjuar zërin e tij; ja kokëfortësia e zemrës".

"Unë mendoj, ka rrëfyer Papa Fracesco – që profeti na mëson sesi të pendohemi ; na mëson se cila është rruga për të kërkuar falje, rrugën e vërtetë". Baruc shkruan që " bashkë me mëkatin na kanë rënë mbi supe edhe shumë të këqija" edhe kjo ka ndodhur pasi mëkati shkatërron, shkatërron zemrën, shkatërron jetën, shkatërron shpirtin : dobëson, sëmur – thotë Papa. Lexohet akoma në pjesën e Baruc " Nuk e kemi dëgjuar zërin e Zotit dhe madje, secili nga ne në vend që të dëgjojë zërin e Zotit ka ndjekur prirjet perverse të zemrës së tij dhe ka bërë atë që është e keqe në sytë e Zotit.

Në thelb, ka theksuar Papa : " Zoti na ka folur, por secili nga ne e ka bërë të kundërtën : ka rënë në idhujtari, ato idhujt e vegjël që ne i krijojmë në çdo ditë, ka bërë atë që është e keqe në sytë e Zotit dhe ka vazhduar, drejtimet e gabuara të zemrës".

" Ne e dimë, - ka thënë Papa,- duke na sugjeruar që të bëjmë një reflektim personal, që në zemrën tonë ka shumë raste të prirjeve drejt mëkateve : drejt lakmisë, zilisë, urrejtjes, keqdashësish ». Dhe të mendojmë pikërisht për shpifjen : ndoshta ju jo, nuk e di, por sa herë unë kam folur keq për të tjerët ? Sa herë unë kam qenë gojëkeq? Shpifja, në fakt, është një prirje e zemrës,e cila e shkatërron jetën e të tjerëve. Edhe më shumë se kaq, nuk i shqyejmë rrobat kur dëgjojmë për luftime, por harrojmë që shpifja është vetë një luftë, është një luftë e zemrës për ta shkatërruar tjetrin. Dhe sa herë Zoti na thotë : "Jo, jo mos shpif, mos fol", ndërkohë që unë bëj atë që dua.

Është e rëndësishme, pra, siç na ka bërë të ditur edhe papa Françesko që të shikojmë gjithnjë mëkatin në këtë raport me Zotin, i cili na do dhe na jep gjithçka, edhe nëse ne bëjmë atë « që duam ». Për këtë arsye na ka sugjeruar "kur ne të bëjmë provimin e ndërgjegjes ose përgatitemi për rrëfim, nuk duhet thjeshtë të rendisim mëkatet, siç është lista e numrave telefonik, ose faturat që marrim nga supermarketi : jo". Ne duhet të njohim këtë mëkat që kemi bërë përpara Zotit : gjithnjë duke matur raportin : " Unë kam bërë këtë gjë përpara teje".

Shumë herë kam nënvizuar që të shkojmë për t'u rrëfyer duke pasur për bazë listën e mëkateve – të shëmtuarat, kjo është e vërtetë, por le të hedhim çdo gjë aty përpara priftit dhe le të rrimë të qetë. Por, - ka vazhduar Papa,- unë pyes veten : ku është Zoti aty ? A kam menduar që ky mëkat është kundër Zotit ? Ah, nuk më ka shkuar në mendje. Por ai nuk është një makinë që të të pastrojë, sikur të ishte një makinë do të na mjaftonte të shkonim në pastrimin kimik dhe do të pastroheshim. Por, - ka shpjeguar Papa, - mëkati është një raport i rebelimit kundër Zotit : është i shëmtuar në vetvete, por i shëmtuar edhe kundër Zotit i cili është i mirë. Atëherë, nëse unë mendoj kështu për mëkatet e mia, në vend që të kalojmë në depresion, unë ndiej atë ndjenjën e madhe : turpin, pandershmërinë për të cilën na flet profeti Baruc. Pasi turpi është një bekim : jemi të bekuar nëse ndiejmë turp përpara Zotit.

Tani ju propozoi një ushtrim për ndërgjegjen personale : Asnjë të mos përgjigjet me zë, por duhet të përgjigjeni me zemër : ju a keni ndierë turp përpara Zotit, për mëkatet e tua ? A keni kërkuar bekimin e të pasurit turp, bekimin për t'u turpëruar përpara teje, o Zot, që të kam bërë të gjitha këto ? Pasi unë jam i keq, shëromë, o Zot. Dhe që Zoti të na shërojë të gjithëve,- ka ritheksuar Papa,- duke na kujtuar që ndjenja e turpit na hap derën e shërimit të Zotit.

Nga ana e tij, ka vazhduar Papa Françesko, - çfarë bën Zoti ? Ai bën atë për të cilën jemi lutur në fjalimin e fillimit : « Zot, Ti na tregon gjithëfuqinë tënde, mbi të gjitha me mëshirën dhe faljen që na jep ». Pra, kur Zoti shikon kështu ne duhet të ndiejmë turp nga ajo që kemi bërë dhe me përulësi duhet të kërkojmë falje : ai që është i gjithëfuqishëm, do të fshijë gabimet tona, do të na përqafojë, do të na përkëdhelë dhe do të na falë. Por, për të arritur tek falja ne duhet të ndjekim rrugën që na mëson profeti Baruc.

Të lavdërojmë sot Zotin, - ka qenë nxitja e Papës- pasi ka dashur që të manifestojë gjithëfuqinë që ka vetë në ndjenjën e mjerimit dhe në falje, pastaj edhe në krijimin e botës, por që kjo qëndron në planin e dytë. Mbi të gjitha në mjerim dhe në falje përballë një Zoti kaq të mirë, që fal gjithçka, që ka kaq mëshirë, të kërkojmë bekimin e të pasurit turp, të ndihemi të turpëruar. Siç shkruan Baruc « Zotit tonë, drejtësinë ; neve çnderimin, pra ndjenjën e turpit ». Dhe me këtë ndjenjë të afrohemi me të që është i gjithëfuqishëm në mëshirë dhe në falje.

Përgatitë: Benardina Shahini

PAPA: JEZU KRISHTI SOT KA EMRIN E ROHINGIAVE

Po botojmë pjesë nga bisedat e Bergolios (29 nëndor, 1 dhjetor) me jezuitët e Mianmarit dhe Bangladeshit. Bisedat janë tejshkruar nga "Qytetërimi katolik" nga drejtori, atë Antonio Spadaro.

Çfarë prisni nga ne ?

"Besoj se nuk mund të mendohet një mision – e them jo vetëm si jezuit, por si i krishterë – pa misterin e Mishërimit. Jezuiti është ai që duhet t'i përafrohet, siç është afruar Fjala e kthyer në mish. Në këtë i bekuari papa Pali VI e ka ndihmuar shumë Shoqninë dhe më 3 dhjetor 1974 na është drejtuar me një fjalim që mbetet plotësisht i kohës sonë.Thotë për shembull : "Kudo, në udhëkryqet e historisë, janë jezuitët." E për të shkuar në udhëkryqet e historisë duhet të lutemi!"

Shumë media kanë thënë se vizita juaj në Mianmar është nga më të vështirat. A është kështu ?

"Ky ka qenë nji udhëtim shumë i vështirë, po. Ndoshta, në një farë pike, ka rrezikuar të fshihej. Por pikërisht sepse ishte i vështirë duhej t'a bënja ! Populli i Zotit është një popull i varfër, që ka etje për Zotin. Ne barijtë duhet të mësojmë nga populli. Prandaj, nëse ky rrugëtim dukej i vështirë, kam ardhur sepse ne duhet të qëndrojmë në udhëkryqet e historisë".

Shpesh ju thoni se duhet të kemi erën e deleve. Disa prej nesh ndjejnë erën e refugjatëve.

"Kam vizituar deri tashti katër kampe refugjatësh. Tre shumë të mëdhenj : Lampeduza, Lesbo dhe Bolonja. Dhe atje puna është në afërsi. Disa herë janë fusha të vërteta përqëndrimi, burgje. Un kërkoj t'i vizitoj, flas hapur, mbi të gjitha me Vendet që mbyllin kufijtë e tyre. Gjëja më e vështirë është se, për të marrë këtë vendim, u është dashur të mbyllin zemrën. Puna e jonë misionare duhet duhet të arrijë edhe tek ato zemra që janë të mbyllura kundrejt pritjes së të tjerëve. Këto gjëra nuk arrihen në sallonet e qyteteve tona të mëdha. E kemi për detyrë të padisim e të bëjmë të njohura tragjeditë njerëzore mbi të cilat kërkohet të heshtet".

Unë vij nga një krahinë ku ka mjaft tensione me myslimanët. Pyes si është e mundur të kujdesemi për këta njerëz që kanë këtë prirje fondamentaliste.

"Shiko, fondamentalizma ka gjithandej. Dhe ne katolikët kemi "nderin" të kemi mes të pagëzuarve fondamentalistë. Është një qëndrim i zemrës që ngrihet në gjykatës të të tjerëve e t'atij që mbështet besimin e tij. Është një shkuarje në thelbësoren - të mëtuarit e shkuarjes në thelbësoren – e besimit, por deri në nji pikë të tillë sa harrohet ajo që është jetësore. Harrohen pasojat. Qëndrimet fondamentaliste marrin disa lloje formash, por kanë bazën e përbashkët të nënvizojnë shumë thelbësoren, duke mohuar jetësoren. Fondamentalizmi mohon historinë, njeriun. Dhe fondamentalizmi i krishterë mohon Mishërimin."

Shënjtëri, ju faleminderit që folët për popullin Rohingia. Janë vëllezërit dhe motrat tona.

"Jezu Krishti sot quhet Rohingia. Ti flet për ta si vëllezër e motra : janë. Mendoj për shën Pedro Klaver, që më është shumë i dashur. Ai ka punuar me skllevërit e kohës së tij. E të mendosh se disa teologë t'asaj kohe – jo shumë, lavdi Zotit – diskutojshin nëse ata kishin një shpirt apo jo ! Jeta e tij ka qenë një profeci dhe ka ndihmuar vëllezërit e motrat e tij që jetonin në kushte të turpëshme. Por ai turp ende sot nuk ka mbaruar. Sot flitet shumë si të shpëtohen bankat. Problem është shpëtimi i bankave. Po cili shpëton dinjitetin e burrave dhe të grave sot ? Gjindja që shkon në rrënim nuk i intereson më asnjërit. Djalli arrin të veprojë kështu në botën e sotme. Nëse do të kishim pak sensin e së vërtetës duhej të skandalizoheshim. Skandali mediatik sot ka të bëjë me bankat, jo me njerëzit. Përballë gjithë kësaj duhet të kërkojmë një hir : të qajmë. Bota ka humbur dhuntinë e lotëve. Pafytyrësia e botës sonë është e tillë që e vetmja zgjidhje është të lutemi e të kërkojmë hirin e lotëve. Kundrejt asaj gjindje të varfër që takova ndjeva turp ! Ndjeva turp për veten, për të gjithë botën ! Më falni, po mundohem vetëm të ndaj me ju ndjenjat e mija...."

Juve erdhët në Bangladesh dhe emëruat kardinal ipeshkvin e kryeqytetit. Si shpjegohet kjo vëmendje?

"Duke emëruar kardinalët jam munduar të shoh kishat e vogla. Jo për të ngushulluar, por për të përhapur një mesazh të qartë : kishat e vogla që rriten në periferitë dhe janë pa tradita të lashta sot duhet t'i flasin Kishës universale. E ndjej qartë se kanë diçka për të na mësuar".

Marrë nga "Corriere della Sera", 14 dhjetor 2017

E shqipëroi: Eugjen Merlika

Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

GATISHMËRIA PËR T'U MËSUAR PREJ TJETRIT

(Pjesa e parë)

Të ndalosh në jetën e përditshme është ngecje, të qëndrosh në një vend është statika dhe të mos përparosh në jetën e përditshme është disfatë e tmerrshme. Kush pajtohet me këtë: ai i nënshtrohet botëkuptimit të quajtur determinizmit , thjeshtë është shkruar prej Zotit, atëherë nuk ka çka të presin nga lumturia dhe as nga dashuria, por do të kënaqet me situatën pasive dhe sterile. Një mendim i tillë ndoshta është nganjëherë diçka tërheqëse, si arsyetim i dobësisë sonë, ose paaftësisë për t'u ballafaquar me jetën e përditshme. Sepse ato virtyte që i kemi dhe ato dhurata që i posedojmë, eventualisht edhe i njohim, atëherë kuptohet se thirremi në ato vlera, në të cilën është njëfarë sigurie. Njeriu i tillë, në kontekstin tonë, është gjithherë në njëfarë frike, ankth nga jeta. Po ashtu ai i refuzon të gjitha gjërat e panjohura dhe të paqarta, edhe pse ndoshta nuk i ka përjetuar ndonjë tragjedi martesore. Megjithatë ai në gjërat e panjohura dhe jo të sigurta i sheh nga këndvështrimi i frustrimit, që është edhe burimi i frikës së përhershme, që i kërcënohet jetës dhe unit të tij. Personi i tillë është vetëm i sigurt në ato gjërat e provuara dhe ashtu ka njëfarë sigurie në vete. Përndryshe çdo hap i ri i bie atij një pasiguri, frikë, kërcënim jete.

Arsyetimi ose racionalizmi bëhet zakonisht pas dështimit në martesë, si fjala bie, vajza apo djali martohen, por martesa e tyre ishte nga fillimi i dështuar, nuk ishin të pjekur për një martesë të tillë, as nuk kishin aftësi përgjegjësie, tani pasi që e kanë humbur lirinë, fëmija është në rrugë etj... Atëherë kërkohen arsyetimet (racionalizimi) dhe fajësohet ai tjetrin, ose i dorëzohet fatit të shkruar.

E natyrshme është për çdo njeri dhe për çdo moshë nevoja e sigurisë dhe përjetimi i saj, vetëm diçka e tillë e fisnikëron dhe e begaton personin. Fakti se e kemi vetëm trupin fizik, që është i ngjyrosur jo vetëm me psike-n por edhe me shpirtin. Sipas gjenetikës individi

paracaktohet në kraharorin e nënës, edhe pse në fillim është edhe i papërcaktuar si dhe i varur prej saj. Zhvillimi si dhe rrethi ndikon në zhvillimin e tij deri që personi nuk e arrin pjekurinë afektive dhe fizike. Gjatë kësaj periudhës individi krijon raportet jo vetëm në gjirin familjar por edhe me rrethin në të cilin jeton, bile ashtu ushtrohet për t'u adaptuar (përshtatë) mjedisit. Në fillim është foleja e gjirit familjar: nënën, babai, vëllezërit, motrat, lodrat. Me arritjen e pjekurisë dhe njohurisë, ai i merr edhe përgjegjësin e jetës mbi vete. Në formimin e jetës, ai fiton gjithashtu edhe statusin social: gruan, bashkëshortin, fëmijën edhe pak do ta ketë edhe themelin e ardhmërisë. Në të njëjtin fushëveprim, ai i siguron vetes edhe vendin e varrezave, edhe pse mundohet të fitojë sigurinë e jetës, duke realizuar me çdo kusht ëndrrën e dëshirave.

Edhe pse siguria është diçka e mirë dhe e mrekullueshme, por po qe se personi e posedon unin e vet të paluhatshëm, atëherë ai, si i tillë hynë në jetë me plotë përgjegjësi si dhe ballafaquar me një jetë tjetër, që është diçka krejtësisht e ndryshme nga ai, dhe e pranon tjetrin ashtu siç është, duke vënë raportin e dialogut (unë – ti), dhe nuk e humb shpresën as kurajën, por ata ecin përpara me një optimizëm.

Mërzia, pasiguria, brengosja, frika, ankthi janë rreziku i përhershëm jo vetëm për individin, por edhe për çiftin martesor. Ata që e kemi në vete shumë lehte mund të humbet. Në qoftë se jam atë çka jam, dhe jo atë çka kam, atëherë mua nuk mund askush të ma marrë këtë siguri që e kam, as nuk mund të ma marrin qëllimin apo kuptimin e jetës, gjithashtu nuk mund as t'i kërcënohem jetës. Qendra e jetës sime është në mua, në aftësitë e mia, për të qenë dhe për ta shprehur qenien time, që është pjesë e pandashme (integrale) karakterit tim, unit tim edhe kjo varet prej meje.

I vetmi kërcenim, që i kërcënohet sigurisë së njeriut, që vlen edhe për sigurinë time personale, është i kushtëzuar në mua, në personin tim: edhe kjo manifestohet si mungesë e besimit ndaj jetës, si dhe në aftësitë krijuese që i kam unë. Në brendinë time qëndrojnë si ato fuqi pozitive që kontribuojnë në fushën e lumturisë, po ashtu edhe ato negative që frenojnë zhvillimin normal si dhe atë e shëmtojnë duke e humbur baraspeshën e jetës, që kontribuon mes tjerash edhe përtacia ime me gjërat tjera që veprojnë kundër jetës sime. Fjala është për rrezikun e brendshëm, që nuk është e pandashme nga qenia ime: rreziku mbetet aty ku mund të humbet uni, që është në mua, në personin tim .

B) I gatshëm për t'u mësuar prej shoqit martesor

Shumica e çiftëve martesor e harrojnë dhe nuk i japin rëndësi faktit, se njeriu duhet të mësojë deri në vdekje. Askush nuk ka lindur i ditur por ketë e aftëson gjatë jetës. Ashtu është shumë e rëndësishme që çifti martesor duhet ta ketë para vetes gjithmonë gatishmërinë për t'u mësuar prej tjetrit, (shokut martesor). Nuk na arsyeton as mosha, as profesioni, as pjekuria fizike, as ligji qoftë i Kishës qoftë ai civil, edhe pse jemi të ngarkuar me përgjegjësi të jetës së përbashkët. Në ne ende nuk ka përfunduar zhvillimi psiko-sociologjik, as psiko-shpirtëror, as ajo psiko-afektive (emocionale). Individi i tillë nuk mund të thirret në pjekurin e martesës. Siç thotë fjala e vjetër: "Tërë jeta e njeriut nuk është asgjë tjetër përpos një shkollë"!

Pjekuria e individit është mjaft relativ posaçërisht nga aspekti i psikologjisë së zhvillimit psikik. Fjala vjen, fara si dhe veza duhet të jetë të pjekura për t'u fertilizuar, pastaj fryti në barkun e nënës duhet të piqet për të lindë, dhe kuptohet se fillon jeta e re pas që lindë foshnja, por ajo nuk mbetet në këtë fazë por zhvillohet duke ecur përpara kah pjekuria, si bie fjala, foshnja duhet të pjekët për të ec ose për të fol, si dhe fëmija pjekët për shkollë, prapë rilindja apo pjekuria seksuale në moshën e adoleshencës. Pjekuria për martesë, që nuk është vetëm ajo fizike por edhe psikike si dhe afektive. Rishtas fillon nga fillimi jeta e re. Mos të flasim atëherë për periudhën e moshuara, së fundit kemi fazën apo periudhën e fundit siç është pleqëria, me një fjalë tjetër pjekuria për ta leshura boten fizike (vdekja). Me tjera fjalë jeta e njeriut nuk është asgjë tjetër përveç një zhvillim konstant dhe pa ndërpre, i cili kalon nga një pjekuri në tjetrën ose nga në fazë në tjetrën (dhe çdo fazë i ka karakteristikat e veta specifike!). Po qe ngel në një fazë të jetës atëherë nga aspekti psikologjik është sëmundje psikike, me të cilën merret psikiatria ose psikanaliza.

Kuptohet vetvetiu se periudha e martesës kërkon ndër tjera edhe pjekurinë seksuale, që është kusht i domosdoshëm për një bashkëjetesë e frytshme. Siç pohon Freud-i, "Dëshira universale është fryma e parë e çdo jete psikike. Ashtu si trupi për ushqim, shpirti digjet për kënaqësi të thella; epshi, kjo dëshirë për kënaqësinë më të vjetër që ekziston, kjo uri e paqetësueshme e shpirtit, e shtyn atë drejt botës. (…) Ajo mund të shfaqet e të çlirohet nëpërmjet ajkëtëve seksuale normale e të natyrshme; ajo gjithashtu mund të spiritualizohet e të realizojë gjëra madhështore në fushën artistike apo fetare. Ajo mund të humbasë rrugën dhe të shkelë në dërrasë të kalbur, të ""rikësohet""përtej elementit gjenital tek objektet më të pazakonta dhe , përmes incidentesh të panumërta, ta devijojë instinktin e mirëfilltë seksual nga sfera fizike. Ajo është e zonja të marrë tërë format e mundshme, që nga shthurja shtazarake deri në drithërimat më të holla të mendjes njerëzore, duke qenë vetë pa formë dhe e pakapshme, ndonëse ndërhyn kudo. Por gjithmonë, në përmbushjen e kënaqësive të ultë e në realizimet më të larta, ajo e çliron njeriun nga etja e tij thelbësore dhe e qenësishme për kënaqësi" .

Është mjaft e rëndësishme edhe edukata seksuale që nga mosha e njomë e fëmijëve. Në moshën e shkollës fillore, si djemtë ashtu edhe vajzat, fillojnë të skuqën dhe të turpërohen, njëri prej tjetrit, si për shembull, të zhveshën lakuriq përpara tjetrit, veçanërisht është e theksuar përpara gjinisë së kundërt. Fëmija ketë gjë e bënë prej pavetëdijes dhe si të tillë ata e parandiejnë, si diçka shumë të rëndësishme edhe sferën seksuale. Si djemtë ashtu edhe vajzat në këtë moshë të zhvillimit ende nuk janë njerëz të plotë, të pjekur, por janë ende gjysmë e njeriut. Vetëm në kuptimin e plotë të fjalës ata pjekën seksualisht kur mund të marrin mbi vetën përgjegjësin e plotë si dhe obligimeve që i kërkon martesa. Kuptohet se është fjala për një mashkull dhe femër, të cilët janë të dashuruar dhe dëshirojnë për të jetuar dhe nda fatin e përbashkët. Bashkimi i të dyve në marrëdhëniet intime si dhe në raportin e ndërsjellët edhe në marrëdhëniet seksuale. Fjala është ku dashuria dhurohet dhe kurorëzohet si dhuratë pakusht si dhe pranohet nga ana e tjetri po ashtu pakusht. Dy individ të bashkuar në emër të dashurisë si dhe dy dhurata që gërshetohen njëra me tjetrën. Me tjera fjalë ata e plotësojnë njëri - tjetrin, dhe si të tillë e formojnë njeriun e plotë. Ndryshe mund të themi, se dy gjysma të bashkuar e përbëjnë një tërësi të plotë. Këtu nuk është fjala vetëm për trupin fizik të njeriut, por edhe për shpirtin që ndryshon shumë edhe prej trupit, dhe mos të flasim për psiken dhe psikologjinë e gjinive, madje për dallimet emocionale si dhe ndjenjat po ashtu edhe dallimet biologjike, endokrinologjie etj.. të gjitha këto faktorë edhe shumë të tjerë ndikojnë dhe japin tiparet dalluese mes gjinive si mes mashkullit dhe femrës, që është e kuptueshme edhe vetvetiu, si i quan John Gray "Meshkujt vijnë nga Marsi, Femrat nga Afërdita". Por tërë urtësia është në çiftin martesor si t'i njohin këto veti dalluese dhe t'i harmonizojnë gjatë jetës së përbashkët!?

Gjërat e thjeshta nuk janë gjithherë aq të qarta, po ashtu nuk shkojnë hap pas hapi në harmoni njëra me tjetrën. Prandaj është me vend njohja e dallimeve të gjinive dhe njëherë urtësia e çiftit martesor për t'i plotësuar dhe për t'i begatuar njëri me tjetrin duke u dhuruar si dhuratë në mënyrë reciproke (ndërsjellat) në frymën e dashurisë martesore.

Kurrë nuk bënë të humbet nga vetëdija se jemi vetëm gjysma e njeriut në rrugën e zhvillimit. Personi i tillë bartë me vete jo vetëm vetitë pozitive, por edhe ato negative.

Bota e vetive dhe fuqive agresive qëndrojnë pothuajse të maskuara, në nënvetëdijen (pavetëdijen) e personit, qofshin ato të dukshme (të pashme), qofshin ato të maskuara (të papashme) të rrënjosura në thellësinë e shpirtit të njeriut. Siç e kemi theksuar disa herë më parë, nuk ka në këtë planetin tonë "Blu" dy veta të barabartë, as në fushën psikike, as psikologjike, as fizike, as shpirtërore, njeriu është unikët. Sa më tepër që dalin në sipërfaqet dallimet dalluese mes gjinive aq më tepër kërkohet harmonizimin e tyre.

Mund të thuhet me kuptimin e plotë të fjalës, se individi si i tillë, është i njëhershëm dhe i papërsëritur në historinë e njerëzimit.

Po ashtu i njëjti individ mund të ngelin në zhvillimin psikik sepse nuk ka pasur rast ose mundësi të zhvillohet dhe të aktualizohet ashtu siç ka dëshiruar!

MËNYRA E BESIMTARIT PËR T'JU DREJTUAR ZOTIT

Kumtesë e mbajtur në Shkodër, 18. Prill 2018, autor, dom Anton Uka

Libri " Fuqia e Besimit" Drita, Prishtinë, 2017, Reflektimet psiko – shpirtërore mbi psalmet e para të librit të Psalmeve, përgatitur nga dom Antoni, kanë disa veçori mjaft interesante. Sigurisht, unë nuk jam personi i duhur që të flas për aspektin teologjik të këtyre reflektimeve, por si besimtare, mund të them diçka.

Kur rrallëherë në të diela nuk marr pjesë në meshë, thuajse gjithnjë lexoj Fjalën që Zoti ka dashur të na thotë atë ditë bashkë me leximet e tjera, përfshirë edhe psalmet. Duke qenë se në vetvete psalmet janë poezi, sikurse thuhet edhe në parathënien e Librit të Psalmeve në Bibël, mendoj se zbërthimi i kuptimit që ato synojnë të përçojnë është diçka jo edhe aq e thjeshtë.

Ndërkohë që lexoja për të parën herë librin, pasi unë kam patur fatin që si lektore ta lexoj akoma në dorëshkrim, në mend më erdhi tregimi "Teologët" i Jorge Luis Borgesit. Në të flitet për disa heretikë të cilët ishin të tillë jo sepse mendonin ndryshe nga kisha dhe dilnin kundër dogmave fetare, por ngaqë kishin kuptuar gabim Biblën në disa pjesë të saj.

A nuk është e vërtetë se sot bota po kalon ndër peripeci luftërash e vuajtjesh për disa arsye, njëra prej të cilave është edhe të kuptuarit e gabuar të një apo një tjetër Libri të Shenjtë?

Pikërisht këtu, reflektimet e dom Antonit, japin një ndihmesë të madhe. Falë tyre, të gjithë, përfshirë edhe mua apo besimtarë të tjerë, mund të kuptojmë më mirë psalmet, një pjesë mjaft e rëndësishme e Biblës dhe e Meshës së Shenjtë.

Nëse më lejoni, dua të marr si shembull veten. Personalisht, pa ndihmën e librit për të cilin kam kënaqësinë të flas, nuk do të kisha pasur mundësinë të kuptoja ashtu si duhet psalmin "Drama mesianike", psalm i cili më ka tërhequr pa masë. Mënyra e besimtarit për t'ju drejtuar Zotit, pyetjet që të gjithë ne bëjmë në çaste dobësie e të tjera detaje aq magjike, sa vetëm aftësia teologjike dhe përshpirtëria e përvuajtur e autorit mund t'i zbërthente në fjalë aq të kuptueshme.

Studiuesit e Biblës, të njohur ndryshe edhe si biblistët, i ndajnë psalmet në: Himne Lavdie, Psalme të Lutjes dhe Psalmet e Falënderjes. Veçoria e psalmeve, reflektime rreth të cilëve përmban i pari vëllim i librit "Fuqia e besimit" është se bëjnë pjesë në të tri këto kategori. Kjo do

të thotë se falë këtij libri, ne mund të kuptojmë edhe disa veçori të përgjithshme të kategorive, çka rrjedhimisht do të na krijonte disa pika referimi për të kuptuar çdo psalm.

Dukuria e psalmeve nuk është një dukuri e izoluar vetëm në Izrael. Falë shtysës së fortë poetike dhe frymëzimit të pareshtur me të cilin janë ushqyer gjithnjë popujt e Lindjes, psalme gjejmë thuajse në të gjithë këto popuj. Emri psalm vjen nga një vegël muzikore e quajtur "psalterion", shumë e njohur në ato zona e përdorur gjatë këndimit. Vegla është pak a shumë simotra e Lahutës këtu në Shqipërinë e Veriut e cila përdoret gjatë të kënduarit të rapsodive tona.

Për t'u ndalur pak në veçantitë e librit, mënyra se si dom Antoni trajton shpjegimin e psalmeve është vërtetë e këndshme, pasi në të ndërthuret thjeshtësia e cila e bën shpjegimin të kuptohet nga të gjithë me një gjuhë të thjeshtë, por plot figuracion dhe mjeshtëria e të zbërthyerit teologjik të psalmit, duke treguar të gjithë ata njerëz që falë tij mund të marrin benefite, bashkë me mënyrën se si t'i pranojnë dhe kuptojnë ato.

Kështu, librin mund ta shohim si çelësin që çel sëndukun e Pandorës në të cilin nuk ka pasuri, por dituri dhe përshpirtëri që vetëm aspekti artistiko - letrar i Biblës i shprehur ndër psalme mund të na japë. Me anë të tij, psalmet i shohim si fjalë të thënë nga njeriu, e njëkohësisht, si fjalë të thënë nga Hyji dhe në fund, nga ajo çfarë lidh njeriun me Hyjin, Kisha. Duke lëvizur sytë e duke ngrohur zemrën me këto reflektime, kuptojmë se psalmisti mund të jemi të gjithë ne. Pasi ai, sikurse edhe vetë autori thotë, "*është njeri i lig e mëkatar*". Po sipas autorit, *"Për këtë arsye, në këngët dhe lavdet e tij shprehen lutje mallëngjyese, se me veprat e tij mëkatare ka*

ofenduar Zotin, ka lënduar vëllain dhe ka shkelur e përbuzur dinjitetin e vetvetes, pra, dinjitetin e të qenurit bir i dashur, i pranuar dhe i pëlqyer nga Hyji."

Dom Antoni, me bujarinë e tij artistike tregon se si "të vjelim" mësimet që na japin psalmet. Kështu, në reflektimin mbi psalmin e parë, ai na thotë se si duke u mbështetur në ndihmën që ai na jep, të kuptojmë dhe t'i rezistojmë tundimeve që vijnë nga djalli, tundimeve që vijnë nga mishi dhe atyre që vijnë nga të tjerët.

Në reflektimin mbi psalmin e dytë, nuk kemi vetëm një ndalje sipërfaqësore në atë çka psalmisti thotë, por një shpjegim të mirëfilltë. Për shembull, nuk thuhet vetëm se projekti për të rrëzuar Zotin është punë e kotë, por jepen arsyet përse është e tillë dhe raste e shembuj që realisht kanë dëshmuar se të rrëzuarit e Zotit është punë e kotë. Në të tillë udhë shpjegimesh, me shembuj e fakte, shpjegohet edhe përgjigja e dhënë nga Hyji apo Intronizimi i të Shuguruarit dhe thirrja për t'iu nënshtruar Hyjit.

Psalmi i tretë, titulli i të cilit është huazuar nga autori si titull i librit të tij, me reflektimin që i bëhet, na tregon situatën dhe kontekstin në të cilin psalmisti e ka shkruar psalmin. Pastaj edhe shpresa që vendoset në Hyjin dhe mënyra se si Hyji e "lexon" shpresën tonë, duke na dhënë në fund një dëshmi: "Shpëtimi vjen prej Zotit".

Sa thashë deri tani e do të them edhe më pas, mund të duken si misteret e psalmeve dhe pak a shumë të tillë janë. Prandaj thashë në fillim se vlen vepra për të cilën jam duke folur: Ajo bën më të kuptueshëm e të prekshëm disa nga misteret që këto krijime përmbajnë.

Me shpjegimin që i bëhet varg për varg psalmit të katërt, kuptojmë mënyrën e duhur se si t'i flasim Zotit, në atë mënyrë që të dëgjohemi prej Tij, pra se si të themi uratë e të lutemi dhe se si ta shohim fenë tonë si diçka shëruese, dhuratë të dhënë nga Zoti.

Reflektimi mbi psalmin e pestë është një ndër gjërat më të vlefshme që kam lexuar. Qysh kur isha fëmijë, pasi lutesha në fshehtësi, pyesja veten pse lutja ime nuk realizohej. Edhe sot, nuk e di për të kujtuar fëmijërinë, apo sepse realisht vazhdoj të ndjehem njëlloj në raport me pyetjen, pas lutjeve të parealizuara, vendos të njëjtën pikëpyetje infantile. "Gjashtë arsyet e mosrealizimit të lutjeve tona" janë ato që pikëpyetjes infantile i vendosin sipër disa pikëçuditëse që vërtetë më çudisin!

Shpesh herë, ata që janë të sëmurë, humbin besimin që kanë në Zotin në vend që ta forcojnë atë. "Lutja e të sëmurit në trup e në shpirt", mënyrat se si ky i sëmurë mund ta drejtojë atë dhe arsyet pse i sëmuri nuk duhet t'ia mohojë vetes mundësinë e komunikimit me Zotin, shpjegohen nga autori në mënyrë aq fluide sa duket sikur sëmundja tkurret para shpresës së ngjallur.

Të drejtët e të përndjekurit janë ata, lutjet e të cilëve "merren shembull". Kështu, mënyra se si ata duhet të luten, e dhënë në psalmin e shtatë, shpjegohet varg për varg nga autori, në mënyrë që edhe ata që nuk janë krejt të drejtë, të arrijnë të gjejnë diçka, në eliksin e pashtershëm të hireve që lutja e të drejtit jep.

Krijuesi është bujar dhe Emri i Tij është shumë i fuqishëm. Kjo fjali mund të duket si diçka dogmatike dhe për jobesimtarin, mund të bëjë pjesë në ata që Atë Fishta i quante "dokrra hinit". Sot kur njeriu është tepër i zënë me aktivitete të përditshme dhe nuk ka kohë as mundësi, pasi nuk dua të them se nuk ka dëshirë,



të vrasë mendjen për të kuptuar të tilla të vërteta, një shpjegim në trajtë reflektimi, si ky i bërë nga dom Antoni i vjen shumë në ndihmë të kuptojë gjithçka kjo fjali, titulli i psalmit të tetë, na jep.

Përse para Hyjit, të përvuajturit janë shumë të dashur? Ku e merr fuqinë Hyji të përulë bakëqinjtë? Për mua, pa baza teologjike siç thashë edhe më lart, janë dy pyetje vërtetë të vështira. Dhe pikërisht mua, e tillë si jam, e paformuar teologjikisht, ky libër më ndihmon të marr përgjigje, jo vetëm për këto dy pyetje, por edhe për shumë të tjera.

Zanafilla e të gjithë mëkateve është krenaria! Ky pohim mund të duket i vakët dhe më tepër një dogmë se sa një e vërtetë, por shpjegimi i dhënë në libër tregon përse të jesh krenar në masë dhe formë të gabuar do të thotë se po i çel shteg mëkatit.

Dikur, nëse dikush kishte kriza besimi, mund të quhej edhe i pafe apo të dënohej. Por sot, qasja karshi kësaj dukurie njerëzore ka ndryshuar. Dhe, për të kuptuar sa më qartë njerëzit që janë në kriza besimi, dom Antoni bën një shqyrtim të dhjetë tipologjive të personave që kanë një krizë besimi, kategorizim i bërë nga psikologu Atë Amedeo Cecini.

"Mos jep dëshmi të rreme!" është një ndër 10 urdhërimet e Zotit. Shpjegimi i psalmit 12 jep lidhjen e gënjeshtrës me jetën e njeriut, rastet kur ajo përdoret, qëllimet dhe pasojat, e karshi saj vendos edhe tradhëtinë, pasi, në fund të fundit, tradhëtia është një gënjeshër me disa komponentë të shtuar.

Pse zemra shqetësohet dhe trishtohet? Si mund të shpëtojmë prej këtyre dy ndjesive që zemra përjeton? Cila është lidhja e dëshpërimit që nga autori i psalmit shprehet duke thënë katër herë "Deri kur" me këto momente jo të këndshme të njeriut, momente të lindura në zemrën e tij? Pyetje eksiztenciale për një të krishterë të cilat marrin përgjigje në këtë libër.

Po ai që nuk beson në Hyjin? Fillimisht, si mund t'i besosh Hyjit? Përse dikush zgjedh të jetë jobesimtar? Cila është lidhja e ndershmërisë me Hyjin dhe besimin e njeriut në të? Sa shumë pikëpyetje të shtruara nga unë personalisht, para leximit të librit! Sot, këto pikëpyetje janë kthyer në pika pohimi, pasi ky libër ka më ka dhënë përgjigje aq të qenësishme, sa bashkë me to, kam pyetur veten si ka mundësi që më parë nuk i kam kuptuar.

Psalmet e tjera, i përkasin lidhjes së Zotit me njeriun dhe njeriut me Zotin, duke vënë herë në qendër të psalmit Zotin e herë njeriun. Dhe, në fund, ky është misioni i këtij libri: Të lidhë Zotin me njeriun në rrafshin e të kuptuarit të këtij të parit nga ai i fundit!

Luljeta Dushi
Shkodër

Ndue DEDAJ
Rreshen

LETRA E PAPËS PALI VI NË 500-VJETORIN E SKËNDERBEUT

Është një letër e Papës Pali VI, që gjysmë shekulli më parë udhëtoi drejt nesh, për të na uruar 500-vjetorin e Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ngaqë vendi ynë nuk kishte më një hierarki të kishës katolike të veten, për më tepër që qeveria e kohës vetëm një vit më parë, më 1967, iu kishte vënë kazmën institucioneve fatare dhe prangat klerikëve të fundit, letra e Papës iu drejtohet udhëheqësve të dy selive të larta kishtare, nga vareshin katolikët në Shqipëri, kardinalëve: Maksimilian von Fyrstenberg, prefekt i Kongregatës së Shenjtë për Kishat Lindore dhe Gergur Pjetër Agaxhanian, prefekt i Kongregatës së Shenjtë për Ungjillizimin e Popujve.

Letra e Selisë së Shenjtë, e dalë nga Roma, mban datën me 17 janar 1968, që ishte viti i pestë i ponfifikatit të Palit VI. "Është kënaqësi për ne t'iu drejtohemi krerëve të dy dikastereve prej të cilave varën katolikët shqiptarë dhe italo-shqiptarë, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së heroit të tyre kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Ai ishte bir i lavdishëm i një toke që pat fatbardhësinë të ishte pjesë e programit apostolik të Shën Palit, ku ai mbolli ndoshta rishtazi farën e Ungjillit. Ky rajon shfaqet si kishë hierarkike që në fillim të shekullit IV. Ipeshkvinjtë e tij, përfshi këtu dhe ata të ritit lindor, ishin në vartësi të juridiksionit papal të Romës dhe mbështetën ruajtjen e pacenueshmërisë së besimit…"

Letra e Papës ndalet veçanërisht te shekulli XV, përndryshe Moti i Madh, i cili "për kombin shqiptar qe një prej periudhave më të vështira, por edhe më të lavdishme të historisë së tij, për arsye të luftërave të pareshtura që iu desh të bënte për t'i qëndruar pushtimit të osmanëve, të cilët, pasi pushtuan kryeqendrën e perandorisë bizantine, kërcënuan Perëndimin. Qendresa e shqiptarëve për rreth një çerek shekulli qe e guximshme dhe fitimtare, falë mbi të gjitha vlerës dhe zotësisë së kryezotit të tyre, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, të cilit i përkujtohet sot 500-vjetori i vdekjes. Mësuam me gëzim se i gjithë populli shqiptar, si në atdhe, ashtu dhe në diasporë, po përgatitet të përkujtojë me një përnderim të rigjallëruar të paharruarin heroin e madh kombëtar. Selia Apostolike dëshiron të bashkohet me këtë përkujtim të figurës fisnike të Gjergj Kastriotit, bir me besë i kishës, të cilin

pararendësit tanë e mbuluan me lavdërime më tepër se çdo hero tjetër të asaj epoke".

Ishte një histori e gjatë ajo e marrëdhënieve të Skënderbeut me Papët dhe Selinë e Shenjtë, duke filluar me Eugjenin IV, Nikollën V, për të ardhur te Kalksti III ose i Madh, i cili luajti një rol të madh në teatrin ndërluftues të kohës mes koalicionit luftarak perëndimor dhe ofensivës së vazhdueshme osmane, duke e mbështetur Skënderbeun moralisht dhe me ndihma financiare nga të ardhurat e kishave të Dalmacisë etj. Është Papa që pasi ka njohur betejat e suksesshme të kryeprijësit shqiptar, e ka "afirmuar" atë në kancelaritë perëndimore. Edhe pasardhësi i tij, Pio i Dytë, vetëm sa i forcoi marrëdhëniet me Skënderbeun. Ai shkon në Ankona për të mbështetur ushtritë perëndimore, që do t'i bashkoheshin Skënderbeut për kryqëzatën antiosmane të radhës, por në mënyrë të papritur vdes atje, ky dyshohet se qe helmuar. Tashmë qendresa europiane kundër depërtimit të osmanëve në Europë nuk kishte vetëm një emër të shquar të mëparshëm, Janosh Huniadin dhe Hungarinë e tij, por dhe Skënderbeun dhe Arbërinë, me epopenë lavdimadhe të Krujës "kryeqytet i bekuar", Besëlidhjen e Lezhës, kuvend historik i prijësve shqiptarë etj.

Skënderbeu, në politikën dhe strategjinë e tij si udhëheqës dhe strateg ushtarak, nuk mund të mos mbështetej në mendjet më të ndritura të epokës së vet, ku këshilltarë të lartë, diplomatë apo të dërguar të tij si ambasadorë në Venedik, Raguzë etj. do të ishin Imzot Pal Engjëlli, Argjipeshkvi i Durrësit, i cilësuar "prelat i nivelit europian" nga Milan Shufflay, Gjergj Pelini nga Novobërda e Kosovës, vëllezërit Gjon, Pal dhe Andrea Gazulli të familjes së njohur të Gazullorëve, abati Pjetër Perlati, prelatët Ndre, Lazër, Pal etj., jo pak prej tyre abatë me ndikim të madh në dioqezat e Arbërisë. Në Romë gjendet dhe Pallati i Skënderbeut, në sheshin që mban emrin e tij, ku kryetrimi ka qendruar me muaj të tërë gjatë hartimit të planeve të luftës, çka tregon për statusin e veçantë, do të thoshim mbretëror që Gjergj Kastrioti gëzonte pranë Selisë së Shenjtë.

Letra e Palit VI sintetizon vazhdën historike 500-vjeçare të shqiptarëve, përfshi dhe arbëreshët e shpërngulur në numër shumë të madh e të vendosur kryesisht në Kalabri e Siçili, që u pritën shumë miqësisht nga vendasit. "Kundrojmë me admirim ruajtjen e këtyre bashkësive shqiptare prej më shumë se katërqind vjetësh të kujtimit të gjallë të Gjergj Kastriotit, nëpërmjet gjuhës, traditave dhe eposeve të etërve të tyre, që qenë shokët e armëve të këtij Heroi. Bashkë me këtë kujtim ata kanë ruajtur besën dhe lidhjen e tyre me Selinë Apostolike, të cilës i kanë dhënë personalitete me dije shkencore dhe virtyte të sprovuara. Na pëlqen të përkujtojmë pararendësin tonë, Klementin XI Albani, që qe gjithmonë krenar për rrënjët e tij shqiptare…"

Papa po ashtu shkruan se Selia e Shenjtë ka mbajtur dhe afirmuar hierarkinë e shenjtë në Shqipëri, duke pritur prej saj kandidatët për mështarë që kishin mësuar në seminarin papnor të Shkodrës. "Të mirënjohura janë për ne meritat e bijve tanë shumë të dashur të Shqipërisë apo me origjinë shqiptare, që u shquan si në fushën e fesë, ashtu dhe në atë letrare kombëtare, para dhe pas pavarësisë së arritur me 1912", thuhet në letër, ku ne fare mirë mund të pranëvëmë emrat e De Radës, Prend Doçit, Nikollë Kaçorrit, Dora D'Istrias, Shtjefën Gjeçovit, Gjergj Fishtës, Ndre Mjedës etj.

Afërmendësh që letra papale nuk mund të mos prekte dhe realitetin e trishtë ku gjendeshin besimtarët shqiptarë atë mot, më 1968. "Kemi ndjekur me zemër të brengosur nga ankthi, këto vitet e fundit, vështirësitë dhe vuajtjet e tyre të shkaktuara nga kufizimi i lirisë së besimit dhe persekutimet që durojnë bashkë me barinjtë e tyre, ndaj dhe iu shfaqim ndjenjat dhe dashurinë tonë atërore krejt të veçantë besimtarëve katolikë. Mejtimi dhe ndjenjat tona prekin gjithashtu të gjithë shqiptarët jo katolikë, ortodokës dhe myslimanë… " Papa nuk harron të kujtojë dhe Zojën e Shkodrës, "e cila qysh pas vdekjes së Skënderbeut përnderohet në Genazzano", si një shenjë e lutjes së shqiptarëve për të ardhmen e tyre sërish të denjë, ashtu siç ka qenë e kaluara e tyre e lavdishme.

Viti 1990 kishte sjellë një realitet të ri politik dhe historik në Shqipëri. Më 1994, në tokën e Skënderbeut, mbërrin Gjon Pali II, i pari Papë që shkilte në vendin tonë, i shoqëruar nga Nënë Tereza. Ai do të shtegtonte drejt Shkodrës, ku në rrënojat e kishës së moçme "Zoja e Këshillit të Mirë" do të meditonte rreth historisë së shenjtores së mërguar në Itali, bashkë me një pjesë të popullit te saj, por dhe rikthimin e shqiptarëve në besimin e ndaluar me dhunë. Katër ipeshkvinj të shuguruar prej tij me atë rast do të ishin hierarkia e re e kishës katolike në Shqipëri, ashtu siç po atë vit do të shpallej nga Vatikani dhe kardinali i parë shqiptar, Dom Mikel Koliqi, 92-vjeç.

Ishte madhështia e Skënderbeut që shkëlqente shekujve, lidhjet e tij me Selinë e Shenjtë, që sollën letrën e pesëdhjetë viteve më parë, teksa nga shqiptarët sot pritet dhe urimi i Papa Françeskut me rastin e 550-vjetorit të Heroit tonë Kombëtar. Papa Françesku, ashtu si Gjon Pali II, është tashmë i "shtëpisë", pasi e vizitoi e bekoi Shqipërinë qysh në fillimet e pontifikatit të tij, duke dërguar dhe më pas mesazhe të ngrohta paqeje, shuguruar ipeshkvinj të rinj dhe shpallur kardinalin e dytë shqiptar, Dom Ernest Troshanin.

ISLAMIZIMI I SHQIPTARËVE SIPAS PROF. GEORG STADTMÜLLER (1908-1985)

(Pjesa e parë)

**** Georg Stadtmüller (1909 - 1985**) është njohës i mirë i historisë së shqiptarëve. Ka shumë publikime mbi historinë e shqiptarëve, sidomos është i njohur libri i tij "Forschung zur Albanischen Frühgeschichte (Kërkime për historinë e hershme shqiptare)". Ai ishte edhe profesor në Mynih (München) në „Institut Geschichte Osteuropas und Südosteuropas an der Ludwig-Maximilians-Universität". Ky punim është botuar në: Jahrbücher für Geschichte Osteuropas, 1955, Bd. 3, fq.404-429, München/Mynih me titull „Die Islamisierung bei den Albanern".*

Shkaqet e përhapjes relativisht të shpejtë të islamit në Siujdhesën Ballkanike - para së gjithash në Shqipëri - nuk ishin religjioze por të llojit juridik dhe ekonomik. Sipas rregullave të së drejtës fetare (Fikh) i takonte çdo mysliman të shtresës së lartë sunduese politike të Perandorisë Osmane, përderisa të gjithë jo myslimanet ishin të përjashtuar plotësisht nga të drejtat politike. Kalimi në Islam kuptohej njëkohësisht edhe si ngritje në shtresën e lartë politike, që gëzonin privilegje të ndryshme. Shtresa e ulët jo myslimane - të ashtuquajturit „Rajah" - ishte gati pa të drejta dhe ishin të detyruar të paguanin tatim (Gjizja) të lartë për frymë të popullsisë. Këto përfitime ekonomike dhe privilegjore të shtresës së lartë myslimane ishin natyrisht një shtytje e fuqishme të „turqizohen" me pranimin e islamit. Në fakt kalimi në islam pasonte thuajse menjëherë pas pushtimeve turke. Gjatë islamizimit në tokën shqiptare ka ardhur te paraqitja e çuditshme e një sinkretizmi religjioz. Kalimi, që gati përherë bëhej vetëm nga arsyet ekonomike, nuk ka ndryshuar fillimisht aspak në pikëpamjet, mënyrat e jetës dhe në zakonet e të „turqizuarëve". Shumë herë kalimin në islam e proklamonte, e bënte vetëm kryefamiljari me çka arrihej liria nga tatimet shtypëse për frymë të popullsisë. Anëtarët tjerë të familjes mbetnin në besimin e krishterë. Deri në mbarim të shek. XVI kalimet në islam kanë mbetur ende të kufizuara në renegata të vetme dhe ato familjare. Popullatën fshatare të Shqipërisë në atë kohë islamizmi ende nuk e kishte përfshirë. Në vitin 1577 Shqipëria Veriore dhe Qendrore ishte krejt katolike. Hierarkia katolike e vendit duket se ka qëndruar edhe më tutje në shtrirjen e vjetër. Argjipeshkvijtë dhe priftërinjtë

vërtet kanë vuajtur nën jo tolerancën turke.

1. Arsyet dhe format e paraqitjes së islamizimit

Shkaqet e përhapjes relativisht të shpejtë të islamit në Siujdhesën Ballkanike – para së gjithash në Bosnjë dhe Shqipëri – nuk ishin religjioze por të llojit juridik dhe ekonomik. Sipas rregullave të së drejtës fetare (Fikh) i takonte çdo mysliman të shtresës së lartë sunduese politike të Perandorisë Osmane, përderisa të gjithë jo myslimanet ishin të përjashtuar plotësisht nga të drejtat politike. Kalimi në islam kuptohej njëkohësisht edhe si ngritje në shtresën e lartë politike, që gëzonin privilegje të ndryshme. Shtresa e ulët jo myslimane – të ashtuquajturit „Rajah" – ishte gati pa të drejta dhe ishin të detyruar të paguanin tatim (gjizja) të lartë për frymë të popullsisë. Këto përfitime ekonomike dhe privilegjore të shtresës së lartë myslimane ishin natyrisht një shtytje e fuqishme të„turqizohen" me pranimin e islamit. Në fakt kalimi në islam pasonte thuajse menjëherë pas pushtimeve turke. Në fillim ishin individë, të cilët „turqizoheshin", pastaj vinin fshatrat dhe më në fund gjithë krahinat dhe rajonet fisnore. Ky zhvillim ndihmohej nga pasiguria e përgjithshme juridike dhe korrupsioni i sistematizuar, ku jo myslimani në raport me nëpunësit turke dhe feudalët ishte i përjashtuar. Ky drejtim i keq i administratës turke, i cili vërehej që nga fundi i kohës së vjetër osmane – pjesa e parë të shek. XVI dhe pastaj në kohën e mesme dhe të vonshme osmane merr përmasa të mëdha e që lidhej me sistemin e shitjes së posteve për çdo vit. Blerja e një posti shtetëror ishte një kapital, i cili duhej të shfrytëzohej sa më shpejt dhe mundësisht të sjellë rentë të lartë, ngase mbajtësi përkatës i ndonjë posti nuk ishte i sigurte se a do të vijë apo jo ndokush tjetër në postin e tij. Prandaj nëpunësit turke përpiqeshin me të gjitha mjetet në mënyrë të pamëshirshme të nxjerrin tatime të larta nga popullata e varfër dhe e torturuar. Përballë këtij despotizmi me shtypje të vazhdueshme popullata kishte mundësinë të zgjedhë mes ikjes në ndonjë krahinë tjetër (ose në Dalmacinë Jugore venedikase fqinje) dhe islamizimin. Nëse ndokush nuk donte ta lëshonte vendin detyrohej të „turqizohej". Të paktën kështu mund t'i ikej shtypjes së rëndë tatimore të aristokracisë myslimane dhe nëpunësve. Nga kjo arsye ekonomike shprehej përhapja e shpejtë dhe e pandalshme e islamit ndër shqiptarë pasi që islamizimi si lëvizje veç kishte filluar. Islami ka ngulë këmbë në shumë vende të Siujdhesës Ballkanike: fillimisht në Bosnjë dhe Herzegovinë. Atje menjëherë pas okupimit turk të vendit (1463) një pjesë e madhe e popullsisë ka kaluar në islam – para se gjithash aristokracia. Motiv i padyshimtë i aristokracisë ka qenë dëshira për mbajtjen e tokave; një arsye tjetër, e cila islamin atje e bënte aq popullor qëndron shumë më thellë. Anëtarët e religjionit bogomil, që ishte shumë i përhapur – e ashtuquajtur „kisha boshnjake" - për shkak të kundërshtimit të tyre ndaj katolicizmit romak, pra mu për këtë pa rezistencë me dëshirë kanë pranuar islamin. Që nga mbarimi i shekullit të XV është bërë një „përforcim" si lëvizje e masës. Pastaj islamizimi prej shek. XVI përfshinte edhe krahinat tjera ballkanike. Atje pjesërisht ndikuan kushtet tjera psikologjike. Në Bullgarinë Lindore përhapja e islamit mbështetej pjesërisht në „turqizim" të popullatës paraturke të krishterë (të ashtuquajtur „Pomakët" në Radope), ndërsa pjesa më e madhe mbështetej me ardhjen, ngulimin e buqëve anadollak, turq dhe tartarë në mënyrë të planifikuar. Në ujdhesën e Kretës është bërë një islamizim në mënyrë të ngjashme si në Shqipëri: pas okupimit turk (1669) bëhej një kalim masiv në islam, një pjesë si pasojë e shtypjes turke, dhe pjesa tjetër nga arsyet e njohuraekonomike.8 Përderisa greku më parë jepte lirinë se besimin, te shqiptarët mesatarisht ishte e kundërta. Shqiptari është i gatshëm të paguajë lirinë nga shtypja politike me çmimin e besimit të trashëguar. Kjo bindje ka gjetur shprehjen e saj në proverbin e njohur shqiptar „ku është shpata, është feja". Ky vlerësim tepër i vërtetë shqiptar i lirisë nacionale, sociale dhe personale ka lehtësuar „turqizimin". Ismalimizimi ka arritur përmasa më të mëdha në Shqipëri , ku atë fuqimisht përfshinte që nga fillimi i shek. XVI. Burime të ndryshme na mundësojnë këtë ngjarje ta përcjellim prej shek. XVI deri në shek. XIX në proceset kryesore dhe t'i njohim shkaqet dhe pamjet e jashtme. Ne kemi një numër të madh të relacioneve Venedikase dhe Raguziane si dhe raportet e klerikëve vizitatorë të ipeshkvijve katolikë që përmbajnë të dhëna të sakta mbi raportet e të krishterëve dhe myslimanëve në vende të veçanta dhe rajone fisnore. Këtyre u bashkëngjiten edhe raportet e udhëtimeve. Gjatë islamizimit në tokën shqiptare ka ardhur te paraqitja e çuditshme e një sinkretizmi religjioz. Kalimi, që gati përherë bëhej vetëm nga arsyet ekonomike, nuk ka ndryshuar fillimisht aspak në pikëpamjet, mënyrat e jetës dhe në zakonet e të „turqizuarëve". Shumë herë kalimin në islam e proklamonte, e bënte vetëm kryefamiljari me çka arrihej liria nga tatimet shtypëse për frymë të popullsisë. Anëtarët tjerë të familjes mbetnin në besimin e krishterë. Për këto shkaqe në ndonjë vend kalonte në islam vetëm një fshat i një fisi përderisa fshatrat tjerë mbeteshin katolikë.Të „turqizuarit" pranonin sipërfaqësisht islamin dhe shkonin të premtëve në xhami për aq sa vëmendja nga rrethi

mysliman ishte e pashmangshme. Fshehtas i qëndronin besnikë fesë së tyre të krishterë, ata i përcillnin edhe më tutje zakonet e krishtera të agjërimit, sakramentet, nderimin e shenjtërve dhe kultet relikte. Kështu deri në fillim të shek. XIX ka pasur një numër të madh tëfshatrave dhe krahinave që kanë qenë „kriptokatolikë“. Pikëpamjet e krishtera dhe zakonet zvetënoheshin në besëtytni. Nga pikëpamjet besëtytnie qëndronin këta të „turqizuarit“ edhe më tutje pranë zakoneve të hershme të krishtera, ata lavdëronin shenjtërit e tyre, shtegtonin në shenjtërore bile edhe i pagëzonin fëmijët e tyre, ata me pagëzim shihnin një mjet mbrojtës magjik.Mirëpokohë pas kohe me kalimin e gjeneratave humb plotësisht vetëdija e besimit të krishterë e të „turqizuarve“sipërfaqësorë.

2. Fillet e „turqizimit“: renegatat e veçanta

Islamizimi gjithkund filloi me „turqizimin“ e individëve të cilëve me këtë u jepej mundësia për avancim, pasuri dhe pushtet. Po kështu ishte edhe në Shqipëri. Që nga okupimi i Shqipërisë nga Turqia ishte pjesëmarrës një renegat shqiptarë me influencë: Veziri i Madh Gedik Ahmed Pasha(mbytet më 1482). Raste të tilla të renegatës shqiptare mbesin prapë deri në gjysmën e dytë të shek. XVI pak a shumë të veçuara. Por që në shek. e XVI një numër i madh i shqiptarëve të „turqizuar“ luanin një rol prirës në ushtri dhe administratën e Perandorisë Osmane. Prej shumë nacionaletve, prej të cilave përbëhej shtresa e lartë e renegatës në Konstantinopojë, shqiptarët qëndronin në vendin e parë, pas tyre për nga numri dhe rëndësia vinin boshnjakët. Në fund të shek. të XVI në Kostandinopojë kishte një numër të madh të shqiptarëve renegatë në poste të larta, pos tjerash dy pashallarë, një Hasseki (gruaja më e dashur e Sulltanit), një dhëndër i Sulltanit. Shumica e vezirëve atëherë kishin qenë me prejardhje shqiptare. Pranë të turqizuarve shqiptarë ishin edhe serbët dhe boshnjakët e turqizuar si elemente kryesore të shtresës udhëheqëse të renegatës qenë atë kohë formohej në kryeqytetin e Perandorisë. Këta renegatë me pushtetin e tyre bëhen udhëhapës të islamizmit. Kështu në fillim u turqizuan vetëm të krishterët ambiciozë ose edhe familje të tëra që donin të bënin emër ose të paktën t'i shpëtonin ngarkesave tatimore, e para së gjithash tatimit për frymë të popullsisë dhe „haraçit në gjak“ (turq. Derşirme). Kalimi masiv në islam, si duket, pastaj, ka qenë në Bullgari dhe në aristokracinë boshnjake. Në krahinat tjera ballkanike një lëvizje e vërtetë e kalimit në islam është bërë së pari në mbarim të shek. XVI dhe fillim të shek. XVII, para së gjithash në Shqipëri. Familjet më të forta të vendit mundoheshin me anë të „turqizimit“ ta shpëtonin pasurinë e tyre dhe të siguronin pozitën që kishin. Me kalimin në islam pranoheshin në shtresën e lartë myslimanë ku fitonin të drejtat dhe përparësitë e tyre. Një shembull i qartë është zhvillimi i dalluar i shtresës së renegatës në qytetin e Shkodrës. Kur me marrëveshjen venediko-turke (1479) Shkodra bëhet turke, një pjesë e shqiptarëve emigroi ndërsa me kohë pjesa tjetër e mbetur “turqizohej“. Sipas një gojëdhëne (që nuk e jep kohën e saktë) thuhet se një ditë të gjithë pronarët e tokave kanë marrë urdhrin nga pashai që ta argumentojnë me shkrim pronësinë e tyre. Përgjigjja e tyre ishte se ata nuk posedojnë kurrfarë shkrese për argumentimin e pronësisë, sepse ata pronat e tyre i kishin trashëguar me gjenerata. Kështu pashai iu lexon një ferman (urdhër) të Sulltanit, me të cilin të gjitha pronësitë e të krishterëve të cilët nuk e argumentojnë pronësinë me shkrim të shpallen toka të Sulltanit. Pastaj pronarët e tokave kishin një mundësi që ta merrnin një dëshmi turke e cila do t'ua kthente pronat, nëse ata do të kalonin në islam. Të gjithë pronarët e krishterë të tokave janë përpjekur që në këtë mënyrë t'i marrin përsëri tokat e veta e kështu si pasojë e saj turqizohen. Pastaj prishen edhe kishat e krishtera në Shkodër ose janë kthyer në xhami. Vetëm jashtë qytetit në bregun verior të Bunës është ruajtur një kapelë.

3. Zhvillimi i islamizimit deri në fillim të shek. XVII

Deri në mbarim të shek. XVI kalimet në islam kanë mbetur ende të kufizuara në renegata të vetme dhe ato familjare. Popullatën fshatare të Shqipërisë në atë kohë islamizmi ende nuk e kishte përfshirë. Në vitin 1577 Shqipëria Veriore dhe Qendrore ishte krejt katolike. Hierarkia katolike e vendit duket se ka qëndruar edhe më tutje në shtrirjen e vjetër. Argjipeshkvijtë dhe priftërinjtë vërtet kanë vuajtur nën jo tolerancën turke. Pastaj – kah fundi i shek. XVI - fillon islamizimi si lëvizje masive. Në fillim të shek. XVII në islam kishte kaluar përafërsisht e 30-ta. pjesë e popullsisë shqiptare. Që nga kjo pikë kohore filloi islamizimi të përhapet më shpejt. Që kur Sulltan Selimi i II. më 1569 urdhëron konfiskimin e të gjitha të ardhurave të kishave të krishtera të Perandorisë (përveç në Kostandinopojë, Brussa dhe Adrianopol) bashkësitë e krishtera bien në një gjendje edhe më të pavolitshme. Falë vetëm gatishmërisë për flijim apostolik dhe qëndrueshmërisë së françeskanëve, që kishin marrë përsipër punën baritore-shpirtërore gjithëkund nëpër provincat turke në shekujt vijues në territoret katolike është mundur të kryhen punët baritore-shpirtërore. Mirëpo ky veprim u ka kushtuar me

vdekje martire shumë françeskanëve misionarë guximtarë. Shematizmi i vitit 1577 i gjeografisë kishtare të Shqipërisë përmban të dhëna të vlefshme mbi gjendjen e dioqezave në veçanti. Në qytetet e Shkodrës dhe Lezhës (Alessio) në atë kohë kishte shumë të krishterë" në rrethin e arqipeshkvisë të Krujës, 300 fshatra të krishtera. „Vescouato Cinense",30 në jug 60 milje më larg kishte 80 fshatra të krishtera, po ashtu edhe argjipeshkvia e mbetur jetime Stephana që shtrihej 80 mile larg kësaj, kishte afro 200. Është theksuar në mënyrë të qartë se në të gjitha këto famulli vlente riti latin dhe që këto famulli ishin nën përkujdesjen e argjipeshkvit të Antivarit

* *

Në rrugën prej Lezhës për Novobërdë, në një udhëtim që zgjatje prej pesë ditë që shpinte nëpër malësitë veriore shqiptare, territori i rrugëtimit katër ditor, i takonte ritit latin ndërsa territori i udhëtimit të ditës së fundit i takonte ritit „grek". Po ashtu në zonën e banuar me serbë në Janieuo (Janjevë) dhe Trepcia (Trepçë) kishte katolikë. Disa vite më vonë mësojmë nga raportet e vizitatorëve apostolikë hollësi të tjera të rëndësishme për gjendjen kishtare dhe politike të atëhershme në provincat ballkanike turke. Në fillim të vitit 1584 Papa Gregori i XIII, i cili përpiqej në mënyrë të veçantë për misionet orientale dërgonte dy vizitatorë apostolikë në Ballkan: Kanonistin e Zarës Allesandro Komulović, dhe jezuitin Tommaso Raggio. Në raportet e vizitatorëve, në bazë të përshtypjeve, Komulović e jep një pamje të qartë për gjendjen e Kishës në këto troje. Të krishterët jetojnë shumë të shtypur nga pushteti osman dhe e dëshironin lirinë. Popullata ballkanike e armatosur mirë do të kishte mundësi ta mobilizonte një ushtri të fortë. Vetëm në Veri të Shqipërisë - deri në pjesën kah Durrësi (Durazzo) - do të ishin afro 40.000 burra të aftë për luftë; i tërë ky rajon i takon Kishës katolike. Në „Epirusin e mbetur" (dmth. Shqipëria jugore dhe Epiri) dhe në Maqedoni numri i „grekëve" ishte shumë më i madh. Atje do të mund të jenë më tepër se 100.000 burra të aftë për luftë. Një mobilizim jo të lehtë do të mund ta paraqiste Hercegovina, Sllavonia, Kroacia dhe Serbia. Në rajonin e Bosnjës dhe Danubit deri kah Beogradi kishte 200.000 të aftë për luftë dhe po aq në Bullgari. Numri i të krishterëve në Detin e Zi nuk do të ketë më pakë se 400.000. Nëse këto të dhëna të raportuara nga vizitatori ndoshta janë të tepruara, mund të konsiderohet si e sigurte se në të gjitha këto territore një pjesë e madhe e popullsisë kishte ruajtur krishtenizmin.34Pak më vonë një relacion në arkivin e Vatikanit (nga fundi i shek. XVI ose i viteve të para të shek. XVII) jep hollësi dhe të dhëna numerike, një paraqitje të pasur të rrethanave kishtare në Shqipëri. Autori, prift anonim, i këtij raporti thotë se vetëm një e tridhjeta e shqiptarëve janë myslimanë(„turqë"), kurse të gjithë të tjerët janë të krishterë edhe atë katolikë të ndarë në shumë parti sipas prirjes së tyre për Papën, Venedikun ose Napolin. Venedikasit duke pasur parasysh interesat e tyre tregtare me Orientin, kërkonin të mbetnin në mirëkuptim të mirë me Portën, kështu refuzuan planin e përkrahur nga Roma dhe Napoli për kryengritjen kombëtare shqiptare kundër sundimit turk. Kjo paraqitje plotësohet nga një shkresë e një prifti vizitator e vitit 1599: numri i katolikëve në Shqipëri në atë kohë ishte 70.000 pa provincën kishtare të (An)Tivarit. Numri i ortodoksëve(„serbë" dhe „grekë") ishte edhe më i madh. Në tërë Shqipërinë ishin vetëm 130 priftërinj (meshtarë), që prej tyre një pjesë e madhe jetonte haptas në konkubinat. Numri i përgjithshëm i popullsisë – pa ortodoksë – ishte 150.000 shpirtëra. Kështu që numri i të „turqizuarve" do të duhej të ketë qenë po aq i madh sa edhe i katolikëve. Katolikët vuanin më shumë nga telashet ortodokse (greke), se sa nga sundimi turk. Me kërkesën e „grekëve" është dashur të paguanin edhe kishat katolike për patriarkalen ekumenike në Kostandinopojë. Në këto kushte të vështira nuk kaqenë e çuditshme që shumë hoqën dorë – para se gjithash në mungesë të priftërinjve – ata pjesërisht bëhen myslimanë, pjesërisht ortodoksë të ritit grek apo serb. Një shembull i qartë i dobësimit kishtar në atë dhjetëvjetësh ishte historia e argjipeshkvisë së(An)Tivarit, që nga mesjeta e vonshme ka qenë si qendër e primatit të Serbisë dhe Shqipërisë.

Në vitin 1571 (An)Tivari i Venedikut, mbas një mbrojtje trimëroje, bie në duart e turqve. Argjipeshkëvi Johannes Bruno d'Olchinio (1551-1571) që kishte marrë pjesë personalisht në mbrojtje është burgosur dhe vdes pas disa vjetësh në burg. Me këtë fillon për këtë rajon, që deri në këtë moment ishte i pastër me katolikë, një krizë e rëndë. Kështu kohë pas kohe, priftërisë ortodokse nga Patriarkana e Pejës, e favorizuar nga Perandoria Turke, i shkon për dore të sprapsë dhe ta shtypë ritin latin. Në qytetin e (An)Tivarit Katedralja e Shën Gjergjit shndërrohet në xhami, ndërtesa argjipeshkvore bëhet rezidencë e guvernatorit turk. Nga 20 kishat e qytetit dhe 10 të rrethit, kursehen vetëm ajo e Shën Elisë dhe Shën Marisë „in Suburbana". Shenjtëroret tjera plaçkiten dhe shkatërrohen, konfiskohen pasuritë e kuvendeve (manastireve) dhe kishave. Një pjesë kalon në duart e ortodoksëve. Prej përafërsisht 30 Abacive të Benediktinëve dhe Bazilianëve (poashtu dhe Abacia e Shën Marisë e murgeshave - femrave - në Rotazio në bregdet, Abacia e benediktinëve në (An)Tivari dhe nga 7 kuvendet (manastiret) e françeskanëve, që

e bënin provincën shqiptare, asnjë nuk i ka shpëtuar kësaj katastrofe. Katolicizmi që në sytë e turqëve ishte si religjion i armikut të vjetër Venedikut, e që ishte i urryer, duhej tani të zhdukej përfundimisht. Argjipeshkvia e (An)Tivarit mbetet tashmë tetë vite jetime (pa argjipeshkëv). Pastaj emrohet Ambrosio Antonio Capizio (o.min.obs.) për argjipeshkëv. Gjatë gjithë kohës sa ishte në detyrë (1579-1599) nuk ka guxuar të rezidojë në qytetin e tij argjipeshkvor. Ai ka qëndruar në Budvë (Budua) të Venedikut fqinjë, prej ku ai pjesërisht kishte disa mundësi t'i kryente, udhëhiqte punët dhe detyrën e tij. Edhe në kohën e pasardhësit të tij Tommaso Orsini (o.s.fr., 1599-1607) s'ndryshon gjë. Argjipeshkëvi, Ambrosio është përpjekur edhe me ndërmjetësimin e diplomacisë venedikase tëndikojë në marrjen e një urdhëri (nxjerrjen e një firmani) të Sulltanit, me anë të të cilit do të ishin mbrojtur personi dhe pronësia e argjipeshkvit nga veprimet arbitrare të nëpunësve vendor turk. Nëpunësi venedikas nuk ishte munduar fare në këtë drejtim ngase ai ishte i mendimit se kjo nuk do të sillte gjë. Kur një ditë argjipeshkvi, megjithatë, shkon nga qendra e atëhershme e Budvës (Budua), i pajisur si vizitatorë për në (An)Tivar, arrestohet dhe futet në burg nga turqit, rrahet me shufër, ku nga ky keqtrajtim edhe vdesë.

Pasardhësi i tij Tommaso Orsini e merr titullin „Vicarius Apostolicus in locis finitimis Turcicaedominationis“. Para se gjithash ai është përpjekur ta mbajë fisin fqinjë serb të Pashtroviqëve (Paštrovići) larg nga shkizma. Vetëm Marino Bizzi, i cili në vitin 1609 emërohet argjipeshkëv i (An)Tivarit ia del, nëpërmjet lidhjeve të tija me një turk në detyrë të lartë të nxjerrë një ferman, me anë të të cilit i sigurohet ushtrimi i plotë i juridiksionit argjipeshkvor në rrethin e tij pa pengesë. Sipas këtij fermani argjipeshkëvit të ri i mundësohet që në vitin 1610 të ndërmarrë një udhëtim vizitatorë nëpër Shqipërinë Veriore dhe Kosovën mbi të cilin udhëtim na ka lënë një raport shumë të vlefshëm Udhëtimi vizitatorë shpinte në tërë provincën kishtare në të cilën bënin pjesë Shqipëria Veriore dhe Dardania („Kosova“). Pikë nismëtare ishte qyteti Budva (Budua) në Dalmacinë venedikase.

Prej aty udhëtimi shpinte në (An)Tivari, Lezhë (Alessio) nëpër territorin Bregumatja në afërsitë vendit Kruaja, pastaj nëpër krahinat malore Mirditë, Prizren, Novobërdë, Novipazar. Përshtypjet janë të shënuara në raportin e hollësishëm të vizitatorit me një pamje të qartë të përparimeve të islamizimit të asaj kohe. Përmasa e islamizimit vërtet ishte e ndryshme në treva të veçanta. Përderisa pjesa më e madhe e popullsisë së rezidencës të argjipeshkvisë së (An)Tivarit e kishte pranuar islamin, fshatrat e të gjithë këtij rajoni, pjesa mes (An)Tivarit dhe Lezhës, kishin mbetur ende të krishtera. Mirëpo islamizimi kishte filluar të depërtojë edhe në pjesët fshatare. Në disa fshatra veç kishte disa familje të“turqizuara“. Tërësisht ishte islamizuar vetëm një fshat i vetëm. Në pjesët kufitare kah rrjedh lumi Mat dhe Ishmi islamizimi kishte arritur shkallën më të madhe. Familje të tëra bile edhe fshatra të tëra janë „turqizuar“, për t'i ikur tatimeve. Raportet mes të krishterëve të mbetur dhe të turqizuarve ishin të mira.

Disa kishin kaluar vetëm sipërfaqësisht por në brendi kishin mbetur të krishterë. Në një fshat myslimanët e martuar me gratë e krishtera jepnin kontributin e tyre për mjetet jetësore të priftërinjve katolikë. Në pellgjet e trevave të Dardanisë islamizimi po ashtu ishte shumë i përhapur. Popullata e vjetër sllave ishte ortodokse. Katolikët ishin kryesisht popullatë e imigruar shqiptare të cilëve iu bashkohen edhe disa boshnjakë dhe raguzianë. Krejt ndryshe ishte gjendja e Kishës në krahinat malore të Shqipërisë Veriore. Atje islamizimi ende nuk kishte depërtuar fare. Luftëtarët e zellshëm të fiseve malore qëndronin të patundur në besimin katolikë. Arsyet e turqizimit ishin vetëm të llojit ekonomik. Njerëzit përpiqeshin t'i largoheshin shtypjes tatimore. Prandaj shumë kaluan vetëm në mënyrë sipërfaqësore e ndërruan besimin e tyre. Nga këto premisa krijohet një sinkretizëm i çuditshëm religjioz.

Të turqizuarit ruanin edhe më tutje zakonet e tyre të krishtera e qëndronin pranë tyre. Në një fshat ata merrnin pjesë në festën kishtare të Shën Elisë sikurse edhe katolikët. Në disa vende i pagëzonin fëmijët e tyre sipas zakoneve të krishtera ngase në pagëzim shihnin një botëkuptim magjik. Raportet mes të turqizuarve dhe të krishterëve duket të kenë qenë gjithkund të mira. Si arsye kryesore e islamizimit të pandalshëm për argjipeshkvinë qëndronte në mungesën e priftërinjve dhe edukimin me mangësi të paparamendueshme të klerikëve. Raporti vizitator cekte shumë shembuj të mjerueshëm. Dy priftërinj në krahinën Bregumatja nuk dinin të shkruanin fare e shumë pakë të lexonin. Argjipeshkëvi ishte dashur që të dyve t'ua mësonte liturgjinë. Raste të tilla të paditurisë kishte edhe në vendet tjera. Padituria e priftërinjve bartte shpejt në popull shumë besëtytni. Këtu vijojnë po ashtu edhe mangësitë morale të priftërinjve.

(Përktheu nga gjermanishtja:
Zef AHMETI)

MOMENTE ME KULTURËN SHPIRTERORE

Më datë 18.04.2018 në sallën e konferencave të Seminarit Ndërdioqezan në Shkodër u bë promovimi i librave "Puthjet e padhëna", "Fuqia e besimit" dhe "Jezusi po bisedonte udhës me ta".

Në praninë e shumë pjesëmarrësve dhe arqipeshkvit të Shkodrës, Mons. Angelo Massafra, u mbajtën kumtesat në lidhje me librat e mësipërm, nga Dom Jetmir Nikolli, Dom Gottfried Ugolini, Luljeta Dushi dhe Fra. Flavio Cavallini OFM.

Libri *"Puthjet e padhëna"* shkruar nga Ermes Ronchi ndër të tjera sqaron se si "Njeriu është krijuar nga Hyji për të dashur e për të qenë i dashur" (Shën Agostini). Kjo për arsye se pikërisht këtu është sekreti i jetës: vetëm në dashuri, njeriu e gjen realizimin e tij të plotë. Libri është përkthyer me mjaft mjeshtri nga Kolë Dedaj.

Një libër tjetër, Dom Anton Uka *"Fuqia e besimit"*, shkruar nga ka të bëjë me reflektimet psiko-shpirtërore mbi 19 psalmet e para të librit të Psalmeve. Autori, me të drejt e përcakton psalmistin si njeri besimtar, ndërsa psalmet i cilëson si shprehje feje dhe dashurie, pra si fuqi i besimit që e përcjell jetën dhe veprën e njeriut në çdo situatë dhe rrethana gjatë tërë harkut kohor dhe hapësirës njerëzore.

Ndërsa libri i Dom Dritan Ndocit *"Jezusi po bisedonte udhës me ta"* është i ndarë në tre vëllime sipas ciklit liturgjik 3-vjeçar dhe ashtu siç shkruan edhe Mons. Angelo Massafra ndihmon si në meditim vetjak, ashtu edhe në angazhimin e ndihmësve të bashkësisë për të mirën e popullit tonë të krishterë.

VITRINË LIBRI



Anton Nikë Berisha

PSALMET

Arqipeshkvia e Shkodrës
Shkodër 2017



Zenepe Dibra

QYTETI QË LINDI NGA NJË KËSHTJELLË

Fishta, Lezhë 2018

Ermes Ronchi

Puthjet e padhëna

Arqipeshkvia e Shkodrës
Shkodër 2018

KUMBONA E SË DIELËS
revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult
Tirazhi: 1000 kopje
Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)
Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: www.kishakatolikeshkoder.com
Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"
Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë